

Letër e kryeredaktores drejtuar gazetës "Nositi"

# Përcjellja e fundvitit

Lexoni në faqen 3



E rrallë: Lasgush Poradeci dhe dr.Misto Marko

## Shkencë-aktualitet

# Apokalips apo "apokalips"? Përmasat e shembjes së botës?



Për festën e Vitit të Ri 2010, që Dielli, me fushën e tij magnetike, fillimisht të na shërojë, duke e transformuar secilin prej nesh në NJERI, që Zoti pastaj, pas tre vjetësh, të ndërrojë mendje e të na e bëjë Diellin, dashnor të përjetshëm PERSERI!

Autori: Petro Prifti & Redaksia e Nositit

Lexoni në faqet 7-8-9

## Profil

### Akademik Kopi Kyçyku Personalitet me përmasa jo të zakonta



Në shkrime të shkruara dhe të botuara më parë Pogradecin e kemi perifrastuar: Qytet i vogël me njerëz të mëdhenj. Dhe për këtë besoj se nuk kemi gabuar.

Lexoni në faqet 5-6

## Personazh

### Respekt dhe dashuri për dr.Miston

Të dy kemi lindur me fat. Në atë kohë kur brezi ynë hipte mbi urën e Volorekës e përballëj me tabelën "Zonë kufitare! Ndalim kalimi!", ne kaptuam kufirin shtetëror. Ai vazhdoi studimet e larta për mjekësi Bukuresht-Rumani, mua m'u akordua bursa për të vazhduar studimet në Akademinë e Arteve të Bukura, Pragë-Çekosllovakia

Lexoni në faqet 12-13



16 Ditë Aktivizëm kundër Dhunës ndaj Gruas



Trajnim për aplikim grantesh, programi IPA-CBC

Për dy ditë me radhë, 16-17 dhjetor 2009, në ambjentet e shoqatës “Unë Gruaja” të qytetit të Pogradecit u zhvillua një trajnim interesant, konkret dhe me shumë vlera për Shoqërinë Civile (OJF) e këtij qyteti. Ky është i treti i këtij lloji në qarkun e Korçës. Seminari trajnues drejtohej nga eksperti i Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar, përfaqësues i “Shoqata Shqiptare e Turizmit, me mbështetjen financiare të “Soros-it”, zoti Genci Pasko, me kordinatore zonjën Eleni Jajçari.

Qëllimi i këtij seminari nisej nga një fakt real i Shoqërisë Civile: njohuritë mbi këto çështje janë shumë të kufizuara, por jo për shkak të kapaciteteve të kufizuara, që nevoiten për të hartuar projektpropozime, por për shkak të procesit kompleks për t’i formuluar ato.

Në këtë aktivitet kish përfaqësues nga shoqatat e biznesit, nga Pushteti Vendor (Bashkia Pogradec dhe komuna Buçimas).

Moderatori zoti Pasko i njohu pjesëmarrësit me procedurat e aplikimit për grante nga Programi i

## Bashkëpunimi ndërkufitar Shqipëri-Maqedoni



Bashkëpunimit Ndërkufitar(CBC) Shqipëri-Maqedoni, që bën pjesë në tërësinë e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, që përfaqësojnë komponentin e dytë të instrumentit të asistencës e paraaderimit të njohur ndryshe IPA.

Nga ky instrument financiar përfitojnë 8 shtetet e Ballkanit Perëndimor, të cilët gëzojnë statusin e vendit kandidat ose potencialisht kandidat nga shtetet anëtare të BE.

Të tillë janë: Shqipëria, Mali i Zi, Sërbia, Bosnja, Kosova dhe

kandidat Turqia, Maqedonia, Kroacia. Zonat përfituese nga ky program janë qarqet e Korçës, Elbasanit dhe Dibrës. Objektivi i këtij programi është promovimi i zhvillimit të qendrushëm në hapësirat ndërkufitare Shqipëri-Maqedoni përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta, që synojnë ndikimin në fushën ekonomiko-sociale, përmirësimin e menaxhimit të përbashkët dhe valorizimin e burimeve njerëzore, natyrore dhe kulturore, forcimin e

imazhit dhe të kohezionit të trojeve ndërkufitare. Nga ky program janë më të favorizuara aplikimet: iniciativat për një zhvillim ekonomik, veçanarisht në fokus mbrojtja dhe promovimi i mjedisit natyror dhe ekosistemeve, rritja e kohezionit social nëpërmjet aktiviteteve “njerëzit për njerëzit”

Kjo përbënte dhe pjesën e parë të përmbajtjes të këtij aktiviteti, duke kaluar në punë konkrete të çdo pjesëmarrësi për mënyrën se si hartohet dhe paraqitet një projekt. Çdo njëri kuptoi dhe praktikoi se çfarë duhet të ketë dhe çfarë duhet të bëjë në lidhje me idenë fillestare, gjetjen e partnerve të lejshëm, përpilimin e analizës me partnerët, vendosjen e qëllimeve, rezultateve, aktiviteteve, përpilimi i kornizës logjike, detajet, propozimi, plotësimi i formateve dhe modeleve të kërkuara. Seminari u vlerësua maksimalisht nga të gjithë dhe të gjithë do të paisen me çertifikata trajnimi.

### OPINION

## Kur sindikalizmi unifikohet me partitë...

Ashtu si mbarë shoqëria, në Demokraci secili duhet të luajë rolin e vet, por vetëm duke u bazuar mbi bazën e Ligjeve dhe rregullave. Në këtë aspekt shoqëria shqiptare në këto vite ka ecur mjaft. Punonjësit shqiptarë të të gjitha fushave nga vitet '91-'92 kaluan në një formë të re organizimi: nga BPSH në Sindikata, të cilat duhet të mbrojnë vazhdimisht interesat e punonjësve me rregulla dhe ligje të reja.

Një dokument i tillë është dhe kontrata e punës që lidhet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Por edhe kjo formë e re sindikaliste sot përfaqësohet nga disa institucione: Sindikatat e Pavarura, Konfederata, por edhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë.

Në një vështrim të parë Sindikata e çdo forme duhet të jetë në opozitë me punëdhënësin dhe njëherësh të kuptojnë se janë partnerë. Në këto kushte duhet të

dinë dhe të vlerësojnë rolin e njëri-tjetrit në këto raporte.

Rol kryesor ka drejtuesi i sindikatës. Ai së pari duhet të dëgjojë dhe të tërheqë zërin e anëtarësisë sindikaliste, të debatojë me pushtetin në të gjitha instancat për problemet që kanë ata, por në asnjë mënyrë nuk duhet të dalë mbi Ligjin.

Kohë më parë në një protestë të minatorëve në Pogradec, kërkohej rritja e pensionit, ulja e moshës. Dikush nga protestuesit u shpreh me fjalë jo të mira për përfaqësuesit e Qeverisë Qendrore.

Duke e vlerësuar jo të drejtë një qëndrim të tillë iu drejtova:- Zotëri! Atë nuk e ke vendosur ti, por vota e një populli, prandaj duhet t’i respektojmë dhe të protestojmë në mënyrë demokratike.

Është e domosdoshme që drejtuesit e sindikatës duhet të dinë se çfarë dhe si të kërkojnë.

Shoqata e Biznesit të Vogël në

qytetin e Pogradecit kërkon me forcë luftën kundër informalitetit, i cili shkakton evazionin fiskal, duke mos paguar asnjë lekë në shtet dhe është bërë pengesë për biznesin e rregullt. Por të gjithë ne, kur shohim se na bëhet ndonjë padrejtësi, me të drejtë i drejtohem Shtetit.

Një problem tjetër: drejtuesit e sindikatave mendojnë se janë të pazëvendësueshëm! Unë them se Jo. Po kalojnë gati dy dekada demokraci dhe një pjesë syresh vazhdojnë të drejtojnë me mentalitete të kaluara. Me zhvillimin e një vendi, siç është vendi ynë, në raport me to duhet të zhvillohet edhe jeta sindikaliste. Shumë drejtues kundërshtojnë vendimin e Qeverisë për pronat e sindikatave, një pjesë rreshtohen përkrah partive politike për t’i sjellë ato në pushtet. Kështu partitë i joshin drejtuesit e tyre dhe ata heshtin, kur duhet të flasin. Në vitin 2008 në qytetin e Përrenjasit

minatorët organizuan një protestë. Midis sindikalistve ishte dhe deputeti i PS, ish-drejtor i një miniere. Sipas një informacioni si drejtor kishte shkurtuar nga puna 130 minatorë, tani ishte pjesëmarrës në protestë.

Një rast tjetër. Një sindikalist i zgjedhur në komunën e Hudënishtit ishte dhe anëtar komisioni i PS. Mendoni se ky do të mbronte interesat e sindikatës? Në atë takim elektoral kuptova se sindikatat përdoren për fushata elektorale.

Në shoqërinë demokratike duhet pranuar se ashtu si kërkon ke dhe detyrime. Një vlerësim pozitiv dua të shfaq për Drejtorin e Sigurimeve të qarkut Korçë, që në emër të sindikatës më ka pritur dhe sqaruar.

Parë në një vështrim dhe hapësirë demokratike, të jesh sindikalist, do të thotë të jesh njeri kërkues. Të kërkosh atë që të takon sipas Ligjit.

**Lavdërim Miminllari**

**POGRADEC,  
31.12.2009, ORA 00.00**

*Letër e kryeredaktores drejtuar gazetës "Nositi"*

I dashur Nosit!

Të kisha premtuar një letër këtë fundvit. Të të shkruaja ca fjalë sinqeriteti.

Si ndjem kur viti 2009 po bëhet gati të shkojë...?

-A dua ta shtyj me mlllef e të rrokulliset në këto pak ditë që kanë ngelur?

Që të mund të marrë me vete këshilla si këto: "Vuajtjet duhet t'i durosh e vetme, të hiqesh zvarrë nga dhimbja, dëshpërimi, të psherëtish, të derdhësh lot, të shtrëngosh me duar zemrën dhe ajo të mblidhet edhe njëherë nga stërmundimi. Të të merret fryma, të të mblidhet ngërçi në stomak, të të shtrëngojë gjoksi si në një morsë e të të buçasin veshët nga zhurma e asgjësë, të ulërih nga përpëlitja e shpirtit e të pyesësh Zotin:

-Ç'mund të ketë më keq se kaq?!!

Eeeeej... Ç'mund të ketë më keq se kaq?!!

Ah!"

31 dhjetor 2009. Edhe pak orë...

T'i lëshojmë si ortek e ta marrin me vete 2009. Ta gremisin në kohë, e pastaj të shuhet krejt.

Ndoshta...



-Dua ta mbaj fort edhe disa çaste më shumë, se mos shkon bashkë me kujtimet e bukura që më ka sjellë, mos ikën e fiket bashkë me shkëndijat e lumturisë që më dhuroi!

-Dua...

Jam konfuze!

E kam kuptuar që duhet të rroj me të tashmen!

E kam kuptuar që e kaluara është pengu që shkruhet me fjalë!

E kam kuptuar që e ardhmja është përfytyrim dhe ankth pa fjalë.

Jam neutrale, gëzime + hidhërim = 0

# Përcjellja e fundvitit

Ky është bilanci, sipas gjuhës që mësova sivjet tek Ekonomiku.

Jo, jo bëj shaka!

Asnjëherë s'mund të ketë një korrelacion perfekt negativ që të neutralizojë gjithçka (ose do të triumfojë trishtimi, ose ... ndoshta ..., s'besoj!) Risku është aty.

*I dashur Nosit!*

Ky ka qenë një vit i veçantë.

Kam gjetur shokë e shoqe të shkollës në FaceBook, kam gjetur miq të vjetër e të rinj.

Kam harxhuar orë të tëra duke menduar se cila është magjia e tij, pse është kaq në modë, pse më ka vjedhur kaq shumë kohë?!

Përgjigjen s'e di.

Ndjesinë e përgjigjes e kam.

Kur hyn në FB ti nuk je më vetëm.

Nuk je më vetëm!!!

Kaq mjafton.

Dhe gjithë bota përjeton ndjesinë se gjithë bota është e vogël.

Kështu, pyetja dëshpëruese që mund të keni bërë ndonjëherë: "A

do të shihemi më në këtë botë?" ndjekur me një psherëtimë fatale ka një përgjigje të gëzuar tani, po po në FB!!! Ha, ha.

I dashur Nosit, ti s'je xheloz që komunikimi ka pushtuar njerëzit, që blogjet, forumet, website, web page, etj. janë hapësira virtuale debati dhe informimi, që të gjithë janë nga pak artistë, nga pak gazetarë, fotoreporterë, sepse fantazia është një dhunti njerëzore.

Sepse të gjithë e kanë një shkëndijë origjinaliteti për të thënë gjëra nga këndi i eksperiencës prej nga ata e vështrojnë botën.

Dhe janë interesante në pafundësi.

...shkëndija dhe përtej dritares...

Aha, kanë filluar fishekzjarrët.

Ora 23.58. S'kam më kohë, në 00.00 duhet të mbaroj editorialin e gazetës.

.....

Por në vend të tij e shkrova këtë letër.

*Gëzuar 2010!*

**Viti**

**Urimi 2010:**

## Një vit më i begatë për të gjithë shqiptarët

Viti 2009 është në ditët e tij të fundit. Por këto janë dhe vigjilje e një viti të Ri 2010, që po na troket çdo ditë e më shumë në portat tona. Atmosfera festive ka ditë që është e pranishme në qytetet tona, por edhe në familjet tona, sipas niveleve të jetesës.

Shqiptarët kudo që janë i urojnë njëri-tjetrit, si çdo vit, një vit edhe më të begatë në të gjitha dëshirat dhe shpresat.

Viti 2010 është viti i fundit i dekadës së parë të mijëvjeçarit të ri. Edhe në këtë dekadë të parë shqiptarët kanë se me çfarë të mburren dhe të urojnë njëri-tjetritin.

Shqipëria në stade të reja zhvillimi: anëtare e NATO-s, është shumë e afërt dita, kur të gjithë shqiptarët do të lëvizin pa viza në hapësirën "Shengen", është pranuar kërkesa për statusin e vendit kandidat për në BE, qeverisë i është dorëzuar pyetësori për të testuar shkallën e përgatitjes së institucioneve shqiptare, janë ndërmarrë një sërë reformash, të tjera edhe më të mëdha edhe më të rëndësishme e presin Shqipërinë.

Shpresat e shqiptarëve për një Shqipëri Europiane janë bërë edhe më konkrete, edhe më të prekshme. Të gjitha këto edhe të tjera na

ngacmojnë dëshirat tona në këtë fundviti dhe fillim viti urimin tonë: Viti i Ri 2010 le të jetë viti më i begatë se vitet e tjera, me hapsira të reja, me arritje të reja dhe nivele edhe më të larta për të gjithë shqiptarët, kudo që janë.

Të gjitha këto shpresa e dëshira kërkojnë para së gjithash një stabilitet politik, që për fat të keq është jo pak i lëkundur. Urojmë që politika dhe politikanët tanë të gjejnë rrugët më të mundshme e më të mira të kompromiseve, të dialogut e të mirëkuptimit, ku në qendër të jetë Shqipëria, shqiptarët dhe e ardhmja e tyre. Politika të

përmirësoj ndjeshëm mjetin e komunikimit masiv, në radhë të parë gjuhën. Të ketë mirë parasysh filozofinë popullore, kur thotë: guha kocka s'ka, por kocka thyen! Me urimin tonë bashkohen mijëra e miliona shqiptarë brenda e jashtë vendit, me shpresën e madhe për një Shqipëri me të vërtet Europiane, me nivele konkurruese, për një jetë akoma edhe më të mirë, për sipërmarrje të suksesshme, për perspektiva të reja në procesin e integritit, për nivele të reja në arsim, shkencë, kulturë, art, ekonomi, infrastrukturë.

Këto janë dëshirat, këto urojnë shqiptarët, këto duhet t'i ketë mirë parasysh politika. Shpresojmë dhe besojmë se kështu do të ndodhë. Edhe njëherë 2010-ta viti i realizimit të ëndrrave dhe dëshirave tona!

**Dhimitër Gegprifti**

**Këshilli Bashkiak është organi përfaqësues i bashkisë.**

Ai përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Numri i anëtarëve të këshillit komunal dhe bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë.

Prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet.

Këshilli i Bashkisë organizon dhe realizon veprimtarinë e tij në bazë të Kushtetutës, Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore" dhe në përputhje me rregulloren përkatëse të tij.

Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij qysh nga krijimi, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.

Ai e zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve nga K.Q.Z. Në këtë mbledhje zgjidhet kryetari dhe zëvendëskryetari me votim të fshehtë.

Këshilli bashkiak ka një kryesi, e cila përbëhet nga: kryetari i këshillit, zëvendës kryetari, sekretari, kryetarët e grupeve të këshilltarëve dhe kryetari i bashkisë ose zëvendëskryetari (ose një person i autorizuar prej tij).

Këshilli Bashkiak ka organet e veta që janë komisionet, që mund të jenë të përhershme ose të përkohshme.

Mbledhjet e këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.

**Këshilli mund të mbledhet jashtë radhe:**

a) me kërkesën e kryetarit të komunës ose bashkisë;

b) me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të tij;

c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj.

Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm



# Këshilli bashkiak dhe mbledhja e tij

komunal ose bashkiak ushtron funksione të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.

Mbledhja e këshillit komunal ose

sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin.

Mbledhjet e këshillit fiksohen në



bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve.

Kur këshilli nuk mbledhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpërndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkatës dhe

procesverbalin e mbledhjes. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë.

Vendimet e këshillit ndahen në:

-vendime që merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

-vendime që merren me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të

anëtarëve të këshillit.

-vendime që merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur.

Këshilli bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë.

Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

Aktet e këshillit afishohen në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Të gjitha shkresat, letrat apo ankesat e komunitetit që vijnë në adresë të këshillit Bashkiak, regjistrohen në zyrën e protokollit të bashkisë dhe mbasi i bëhen të njohura kryetarit të këshillit bashkiak, rikthehen në zyrën e protokollit për vazhdimin e procedurës me to.

Administrata e bashkisë shqyrtton problemet e ngritura në to dhe del me propozime konkrete për zgjidhjen e tyre. Në mbledhjen më të afërme të këshillit, sekretari i këshillit i bën të njohur këshillit bashkiak duke informuar për letrat, ankesat, shkresat e ardhura në adresë të këshillit dhe sipas rastit paraqet propozimet e zyrave të administratës së bashkisë.

**Kleda Shyta**

### Shkruar nga Dhimitër Gegprifti

Në shkrime të shkruara dhe të botuara më parë, Pogradecin e kemi perifrazuar: Qytet i vogël me njerëz të mëdhenj. Dhe për këtë besoj se nuk kemi gabuar. Është provuar katërcipërisht në fushën e letrave, të arkitekturës, të penelit, por edhe në fusha të tjera.


#### Vazhdimësi në kohë të reja

Ajo që është e dallueshme edhe sot: vazhdimësia e kësaj dukurie me personalitete të rinj, në fusha të reja me ndihmesa të konsiderueshme dhe të vlerësueshme nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Personazh i shkrimit tonë është personaliteti me përmasa jo të zakonata, pogradecari Akademik Kopi Kyçyku.

Jo në ditë të zakonata, por as edhe në stinë të përcaktuara rasti mund ta sjellë të shohësh një njeri me një ecje disi të shpejtë, me një fytyrë disi esmere në të qeshur, impulsiv, që nga momenti në moment mund të dëgjosh ngjarje të jetuara, kuriozitete, histori, personazhe historike të jetës së përditshme, por edhe nga jeta ndërkombëtare. Atë pa frikë mund ta takosh në çdo ditë të javës e stinë të vitit. Jo rrallë ato të shoqërohen me sentenca filozofike, por edhe popullore nga kombe të ndryshëm e në gjuhë të ndryshme.

#### Pasaporta e Akademikut...

U lind në Pogradec më 30 qershor 1943 në një familje me rrënjë të lashta e ardhur nga Rodokali i Poshtëm, kur ishte e dëgjuar vetëm Kazaja e Starovës. Në këtë vështrim Kyçykët janë ndër bashkëthemeluesit e qytetit, që tre shekuj më parë u quajt Pogradec. Shkollën fillore, shtatëvjeçaren dhe të mesmen i mbaron në vendlindje më 1960 me rezultate të shkëlqyera, për të cilat është dërguar me pushime në Bullgari. Studimet e larta i filloi në Bukuresht të Rumanisë në institutin me tradita shekullore për naftë, gaze dhe gjeologji dhe i përfundoi në Universitetin e Tiranës. Këtu fiton çmim të parë nga 126 kandidatë për shkenca të sakta. Pas prishjes së marrëdhënieve kthehet dhe mbaron në Shqipëri, duke marrë përsëri dy çmime të larta. Fillon punë në



Taxh Mahall, tetor '97

## Akademik Kopi Kyçyku Personalitet me përmasa jo të zakonata

Ndërmarrjen Gjeologjike Pogradec. Mbaron fakultetin Histori-Filologji me korrespondencë. Në vitin 1966 zgjidhet Deputet pa parti dhe njëherësh zëvendëskryetar i Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Pogradecit.

Kryen stazhin aso kohe si kandidat në minierën e Çervenakës. Më 1974 në Televizionin Shqiptar. Më 1989 në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe më vonë shef sektori në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Nga viti 1994 zhvendoset në Bukuresht, ku kish shkuar kohë më parë me aktivitete shkencore. Bëhet anëtar themelues në

Fondacionin European "Nikolae Titulesku", në shoqatën e "Të Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare", bën pjesë në "Shoqatën e Sllavistikës dhe Ballkanistikës" si dhe në "Komitetin Drejtues Ndërkombëtar të Qendrës së Studimeve Ndëretnike dhe Komunikimit" pranë Akademisë së Shkencave të Rumanisë".

Është zgjedhur zv. President i Kongresit të Botës Shpirtërore Rumune. I vetmi intelektual i huaj. Pedagog në universitete Rumune për Historinë e Ballkanit, gjuhën italiane, Historinë e Turqisë si dhe leksione për Afrikën e Veriut e të Kaukazit me tekste të hartuara vetë

në gjuhën rumune. Është marrë edhe me përkthime për të cilat ka marrë vlerësime të larta.

#### Poliglotti, shkrimtari dhe përkthyesi...

Gjuhët e huaja nuk i mëson dot kurrë si gjuhën amtare, shprehet Kopi. Dëshira e madhe dhe vullneti për të studiuar e motivon Akademikun të studiojë, të përvetësojë dhe të mbrojë nëntë gjuhë të huaja: Frëngjisht, Rusisht, Gjermanisht, Turqisht, Rumanisht, Sërbo-Kroatisht, Anglisht, Maqedonisht. Por ai nuk është ndalur këtu. Tenton edhe për gjuhë të tjera, si Bullgarisht, Hungarisht dhe Hebraisht. Këto gjuhë i kam parë si mjet për t'u thelluar në studime të mëtejshme dhe jo si qëllim në vetvete"-na shpjegon Kopi. Ai është sot bashkëthemelues dhe botues i revistës dygjuhëshe Shqip-Rumanisht "Haemus", të cilën e menaxhojnë At e bir (Ardian Christian Kyçyku), po ashtu edhe shoqatën shqiptare me të njëjtin emër.

Të dyja këto veprimtari shkencore vazhdon në rrëfimin e tij, janë kthyer në tribuna manifestimi të shqiptarizms në fusha të tilla, si Historia, Gjuhësia, Letërsia, duke përfshirë dhe të drejtat e shqiptarëve të kudondodhur me argumentet përkatës.

Vend të veçantë kanë zënë në fushën e përkthimeve nga bota shqiptare: poetë, prozatorë, arkitektë, gazetarë, jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga Kosova, si: A.Podrimja, A.Zeneli, B.Sefaj e të tjerë. Edhe përkthimi është një aktivitet i hershëm, me krijimet e autorëve të vendeve të ndryshme në faqet e revistës "Nëntori", "Drita", "Hosteni", "Zëri i Rinisë", si dhe për Shtëpitë Botuese "N.Frashëri" dhe "8 Nëntori", si: "Mjeku i asistencës" të Xhuzepe d'Agata, "Rini e vështirë" të B.Smith, "Penda e kaltër" të Kolin Tile, "Jeta e Emineskut" e Këlineskut, "Skëterra e terrorit nazist" të Zhak Delary.

#### Akademiku dhe aktiviteti...

Temën e disertacionit e ka mbrojtur në Universitetin e Tiranës në vitin 1985 dhe më pas në atë të Stambollit me temë: Republika e Turqisë në vitet 1945-1985, marrëdhëniet e saj me botën, veçanërisht me Shqipërinë, punim 335 faqe ende i pabotuar.

vijon në faqen 6

## Akademik Kopi Kyçyku

# Personalitet me përmasa jo të zakonata

vijon nga faqja 5

Në fushën e letërsisë artistike ka shkruar e botuar vite më parë kryesisht për fëmijë, por edhe për të rritur në fushën e humorit rreth 19 syresh. Drama me një akt, skeçe, pamflete, fejtone, reportazhe, përshkrime, poezi, të cilat kanë mbetur të shpërndara në faqe revistash, gazetash, emisione televizive e radiofonike.

Në veprimtarinë akademike vend të konsiderueshëm ze Turqia, që sipas autorit motivohet e trajtohet si vend fqinj për arsye të një sërë elementësh historik e fetarë, psikologjik të përbashkët.

Për këtë shtet i kish folur edhe gjyshi nga mëma Leon Kristo, i cili kish ndenjtur 26 vite në atë qytet.

Futja në arkivat turke në vitin 1969, zotërimi i turqishtes së re e ndihmuan akademikun të njihet me një material të pasur të historisë moderne të shtetit turk.

Arritjet shkencore e kanë bërë të njohur edhe në shtete dhe universitete të tjera të Europës.

Ka dhënë cikël leksionesh në Algjer e Tripoli. Referate dhe kumtesa në Romë, Kaljari, Stamboll, Ankara, Kajseri, Tripoli,

Nju-Deli, Zagreb, Prishtinë, Sentetjen, Sofje, Budapest, Baku, Londër, Odezh, Kishniev.

Aktiviteti shkencor me shoqatën kuturore shqiptare dhe revistën "Haemus" në Bukuresht është një fushë tjetër e veprimtarisë shkencore. Në to marrin pjesë dhe bashkëpunojnë dhe shtetas të huaj, që e duan shtetin dhe kulturën shqiptare dhe e propagandojnë atë. Një nga drejtimet themelore të punës është ruajtja e traditave dhe gjuhës shqipe për shqiptarët me banim në Rumani, pasi një pjesë syresh janë përthithur nga kultura rumune.

Në vitin 2008 ka krijuar në Londër shoqatën "Publication and Education Services", ndërsa në mars 2009 ka themeluar dhe drejton revistën "The Eastern European Messenger" në Londër, vetëm në anglisht. Kjo revistë e përmuajshme u drejtohet emigrantëve të të gjitha etnive që jetojnë e punojnë në Britaninë e Madhe. Në këto momente ndër të tjera është duke përgatitur një punim të gjerë për mundësinë e botës Eurolindore në kontekst historik gjatë shekujve në gjuhën rumune. Mjaft voluminoz, mbase

mijëra faqe, synon nxjerrjen në pah me argumente të përpjekjeve të kombeve të pjesës Lindore të Kontinentit Plak në mbrojtje të identitetit dhe mëvetësisë së çdo populli.

Ai thekson: "Do të përpiqem të sjell fakte bindëse me morinë e elementëve të përbashkët kulturor, shpirtor, zakonor të të gjithë banorëve të këtyre trevave, pavarësisht nga prejardhja etnike apo gjuha që flasin.

Këtë e mundëson njohja e gjuhëve të huaja, si mjet i pazëvendësueshëm. Ky aktivitet kaq i dendur dhe me këto përmasa lejon që të vlerësohet në shtetin Rumun si pedagog. Kjo tregon se kultura e tyre është më e emancipuar se në Shqipëri.

### Epilog shpirtëror i një personaliteti...

Nuk mund të lësh pa evidentuar dhe natyrën shpirtërore të këtij Akademiku të përkushtuar shkencës. Ai nuk ngurron të shprehet bindshëm dhe sinqerisht se gjithmonë e kanë munduar veprimet e tij ndonjëherë të nxituara, fjalët e pamenduara e të papjekura që ka nxjerrë gjatë

viteve duke hequr një paralele me pagjumësinë e qengjit në një fabul, të cilat i ka paguar me dhjetra netë të bardha.

Në gjykimet për të tjerët është përpjekur të jetë sa më objektiv, por nuk mendon se vetëm ai posedon të vërtetën e pakundërshtueshme. Në përplasjet e mia janë edhe mëkatet e mia, na shpjegon Ai. Por asgjë nuk kam bërë me para ose prapamendim.

Vendlindja është fatalitet në kuptimin gjithpërfshirës të këtij termi. Nënë, babë, vëlla, motër nuk të bëhet kush. Pogradeci im është i dashur sa më s'ka edhe sikur t'u jepte shkas të tjerëve ta qortojnë, vë në dukje Kopi.

Vlerësimet që më janë bërë nga institucione e të tjerë i kam konsideruar si një llotari, të cilën, natyrisht, mund ta tërheqin ata, që e meritojnë. Një ndër ta mund të jem edhe unë, por gjithnjë atë e meritojnë edhe të tjerë. Pogradeci ka plot si unë, jashtë tij ose jashtë Shqipërisë. Nuk kam asnjë pretendim apo ankesë, por nuk e fsheh faktin se po të më bëhej ndonjë vlerësim sado modest, do të shprehesh me mirënjohje të çiltër, duke e cilësuar më të çmuarën se nderimet që më janë bërë nga të huajt.

"Kur jam në Shqipëri më merr malli për Rumaninë, kur jam në Rumani më qan zemra për Shqipërinë", një sintezë kjo mëse kuptimplote për një personalitet të këtyre përmasave.

## Teatri Lëvizës i Fëmijëve!

Me mbështetjen e ECSE dhe Bashkisë së qytetit u fitua projekti "Teatri Lëvizës" i cili u projektua dhe u zbatua prej meje. Libreti u shkrua nga dëshira ime për të nxitur fëmijët që edhe në pushimet verore: libri të jetë miku më i mirë, dëshira e parë e fëmijëve. Për të realizuar këtë teatër u përgatitën 13 fëmijë të moshës 11 dhe 12 vjet, të cilët u zgjodhën nga kampet verore të cilat janë të pranishme në qytetin tonë të Korçës. Dekori u përgatit nga djali im, piktor, i cili ka mbaruar në Akademinë e Arteve të Bukura. Gjithashtu edhe kostumet e personazheve u përgatitën me kujdes, si edhe maskat e personazheve.

Pas një pune intensive u realizua me sukses shfaqja e cila u dha për herë të parë atje ku i kishte fillësat e

para: në prani të fëmijëve që frekuentonin kampet verore. Shpejt ky teatër do të bëhej i njohur për fëmijët dhe komunitetin sepse ai do të ishte i pranishëm në të gjitha sheshet e qytetit ku argëtoheshin dhe çlodheshin fëmijët dhe të moshuarit. Sot në ditën e fundit të javës së trashëgimisë kulturore, të shpallur nga Bashkia ky teatër u bashkua me fëmijët kërcimtarë të shkollës "Mësonjtorja e parë Shqipe", duke patur për spektatorë fëmijët e klasës së katërt. Po ku u gjenden fëmijët kërcimtarë?

Këta fëmijë që u përgatitën nga unë pa shpërblim, për të vërtuar se ka ardhur koha që në shkollat tona të futen orët e kërcimit artistik. Po ky grup kërcimtarësh përfaqësoi shkollën në Fest-Karnavale 2009,

me një kërcim: tango.

Një aktiviste e talentuar e gruas do të shprehej për teatrin lëvizës të fëmijëve: "Ky teatër është një pjesë e Qendrës Kulturore."

Po! Ka ardhur koha që çdo shkollë të ketë: një qendër kulturore: grupin e kërcimit, teatrin, recitimet, pikturës, kitarës, meqënëse qyteti ynë e adhuron këngën me kitarë. Gjithashtu grupi i letrarëve të rinj. Po! çdo shkollë duhet të bëhet një Qendër Kulturore, ku fëmijët sipas prirjeve të tyre, të gjejnë veten e tyre. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka menduar dhe mendon për klasat sportive, por për klasat, orët e artit nuk ka menduar! Ka ardhur koha që artistët të jenë të detyrueshëm në shkolla për të dhënë dijet e tyre. Mësuesit që kanë orët e aktiviteteve duhet t'i shfrytëzojnë ato çdo javë...Mësimin e vizatimit apo të muzikës duhet ta japin artistët e dalë nga Akademia e Arteve të Bukura,

dhe jo të zëvendësohen me mësuesit që nuk kanë asnjë lidhje me artin, vetëm sepse duhet të plotësojnë orët e tyre. Kjo praktikë duhet zhdukur në rradhë të parë nga drejtuesit e arsimit.

Artisti i Popullit Vangjush Mio jepte artin e vizatimit në Liceun Francez. Kristo Kono, Artist i Popullit, i cili kishte mbaruar Akademinë e Arteve në Paris, jepte mësimin e edukatës muzikore që para çlirimit. Ky është një shembull i qartë për vlerësimin në maksimum të artit. Teatri Lëvizës tani filloi fazën e tij të dytë, atë të shfaqjes në ambientet e shkollave. Le të nxisim fëmijët të jenë pjesëmarrës në shfaqje me fabulat, tregimet, vjershat dhe këngët e përgatitura prej tyre...Pra spektatorë edhe aktorë, këngëtarë, etj. Të kurojmë fëmijët: Sepse kështu kemi kulturuar KOMBIN.

Andrea Pepi, aktor

## Dhuratë për festën e Krishtlindjeve, për rrugën e Diellit, gjithnjë, lart e më lart mbi ekuatorin qiellor, për të na ngrohur e ndriçuar më shumë, mendjet e zemrat tona PERSERI!

Për festën e Vitit të Ri 2010, që Dielli, me fushën e tij magnetike, fillimisht të na shërojë, duke e transformuar secilin prej nesh në NJERI, që Zoti pastaj, pas tre vjetësh,

të ndërrojë mendje e të na e bëjë Diellin, dashnor të përjetshëm PERSERI!

Autori: **Petro Prifti**  
Redaksia e Nositit


Më mirë,  
Ta marrim veten me të mirë!  
Apokalips apo "apokalips"?  
Katakлизëm apo "katakлизëm"?  
Katastrofë apo "katastrofë"?  
Përmasat e shembjes së botës?  
Kur? Në fund të vitit 2012 apo në fillim të 2013-ës?

Tronditja shkencore amerikane apo shqetësimi rus?

Si do ta qëllojë Dielli Tokën për të tretën herë?

Mediat tona të shkruara dhe elektronike, kohët e fundit, duke u mbështetur në informacionet shkencore botërore, kanë përhapur disa njoftime tepër tronditëse për njerëzimin. Ngjarje natyrore të frikshme e shqetësuese në Tokën tonë, kanë shoqëruar jetën e njerëzimit që në krijimet e saj. Ato, për fat të mirë deri tani, kanë qenë me pasoja negative vetëm për një pjesë shumë të vogël të njerëzimit. Kështu, mund të përmendim tërmetet, vullkanet, bombardimet meteorike, sulmet e asteroidëve, luftërat, përplasjet me kometat, tufanet oqeanike apo tsunamet, epidemitë, zjarret, thatësitrat, përmbytjet, luftërat termobërthamore, epidemitë,

ngrohja globale që me siguri do të shmanget etj, etj, për të cilat bëhet fjalë në librin tim të titulluar ASTRONOMI, sidomos në faqet 163-164 e 165-169. Deri tani kemi qenë optimistë për të shmangur frikën, për të shmangur shqetësimin, për të evituar alarmin, nga ndikimet e dukurive qiellore apo astronomike në Tokën tonë, në jetën tonë. Mirëpo, shuplaka e tretë e Diellit në drejtim të Tokës sonë, që do të jepet, sipas shkencëtarëve amerikanë në fund të vitit 2012 ose sipas shkencëtarëve rusë, në fillim të vitit 2013, do të jetë, duke e marrë shpirtin me të mirë, grusht Nokdauni, për të mos thënë grusht Nokauti, për njerëzimin në Tokën tonë. Shokimi bëhet tmerrues, sepse shkencëtarët deri më sot, nuk janë



# Apokalips apo "apokalips"? Përmasat e shembjes së botës?

në gjendje të parashikojnë efektet shkatërrimtare të Dashakeqësisë së Diellit, që do të shfaqet për të parën herë ndaj Tokës sonë, për të parën herë nga Dielli, që ka qenë dashnori ynë i përjetshëm. Le të njihemi më gjerësisht me "Dackën" e tretë Diellore. Shkencëtarët rusë, duke u bazuar në të dhënat e Observatorit Tesis, që është vendosur në bordin e satelitit të tyre "Koronas-Foton", në datat 22 dhe 23 prill të këtij viti, kanë fiksuar shpërthime materiale nga brendësia e Diellit në hapësirat kozmike, që i tejkalojnë të gjitha parashikimet. Shpërthimet e këtyre datave krijuan gjuhë të

zjarra e të gjata, pra protuberanca, që e kaluan 50 herë diametrin e planetit tonë, ose 50.13400 km = 670000 km, që është më pak se gjysma e distancës së Tokës sonë nga Dielli. Këto distanca dëshmojnë për energjinë e jashtëzakonshme e të paparashikuar të këtyre shpërthimeve. Shkencëtarët njoftojnë se shpërthimet e fundit të Diellit, pra të 22 e 23 prillit ishin drejtuar nga Toka, po jo fare përballë saj, prandaj nuk e cënuan atë, ndërsa i treti, ka rrezik të na dëmtojë sepse Dielli, gjatë rrotullimit të tij rreth boshtit të vet, me periode rreth një muaj, do të ndodhet në një

pozicion gjeoefektiv, (ndikues mbi Tokën), në të cilën shpërthimi do të jetë fare përballë Tokës dhe valët magnetike të këtij shpërthimi do të "puqen", do të takohen me planetin tonë. Të gjithë e dinë që fusha magnetike nuk perceptohet nga shqisat, as të të parit, as të të dëgjuarit, të prekurit, të nuhaturit apo të të shijuarit, por ajo është reale dhe tepër e fuqishme në rastet për të cilat po flasim. Mendoni dy magnetë, në formë shufre apo patkoi, një në dorën e majtë e tjetrin në të djathtë. Duke i afruar ata me polet e kundërta apo të njëjtë

vijon në faqen 8

# Apokalips apo "apokalips"?

## *Përmasat e shembjes së botës?*



vijon nga faqja 7

lehtësisht kuptohet forca jo e vogël shtytëse apo tërheqëse e tyre. Dy magnetët tërhiqen fort kur afrohen polet e kundërta ashtu si çiftet e dashnorëve të sekseve të ndryshme dhe shtyhen, kur polet janë të njëjta, si dashnorët apo dashnoret e sekseve të njëjta, kur nuk janë meshkuj homoseksualë, apo femra lesbike. Përfytyroni tani dashurinë "vrasëse" të magnetit Diell me magnetin Tokë.

Me sa duket, Zoti, jo me rrufetë flakëruese të Zeusit, ka zgjedhur Diellin, për të na ndëshkuar ne, me "rrufetë" shkrepëtimtare magnetike të tij. Shpërthimi i lëndëve është një proces normal në jetën e Diellit, por të habit fakti që po ndodh, për fatin tonë të mirë, në sfondin e një aktiviteti minimal të tij, nivel të cilin ai e arrin vetëm një herë në 100 vjet, (më saktë në 200 vjet, shënimi im). Energjia e yjeve si dhe e Diellit tonë, buron nga reaksionet termobërthamore që ndodhin në to.

Siç dihet, një shpërthim si ata që ndodhën, për të flakur në distanca aq të largëta sasi të mëdha lëndësh, kërkon energji të jashtëzakonshme dhe shkencëtarët ende nuk e kanë të qartë se ku e gjeti Dielli gjithë atë energji, që shpërtheu disa herë rresht në kushtet e sipërpërmendura. Shpërthimet e fuqishme të Diellit ndikojnë shumë në sferën magnetike

të Tokës. Ato shkaktojnë jo vetëm aureola boreale, por edhe stuhi magnetike që mund të sjellin avari të rënda në fushën elektroenergjitike, madje shumë nga bashkëpunëtorët e Akademisë Amerikane të shkencave, presin nga shpërthimet e pritshme të Diellit, fundin e botës dhe e parashikojnë këtë më 22 shtator të vitit 2012, ndërsa rusët, në fillim të vitit 2013.

Në një punim shkencor me titull: "Kërcënimet e motit kozmik dhe pasojat e tyre sociale", thuhet se atë ditë, Dielli do të flakë në Kozmos një sasi kolosale gazrash të nxehta, të cilat do të shkaktojnë stuhi gjeomagnetike, (stuhi magnetike për Tokën), të paparë ndonjëherë. Stuhija magnetike, (jo thërmijat), vjen në Tokë për 8 minuta. Paralajmëtare e Apokalipsit do të jetë një aureolë boreale, e cila do të shihet, (si s'ka ndodhur ndonjëherë, nga të gjithë banorët e globit e jo vetëm nga ata të vendeve polare), për më tepër dhe gjatë ditëve me Diell!!! Pastaj do të ndodhë një "BLEKAUT" global dhe gjithë sistemi energjistik i PLANETIT tonë do të ZHDUKET... Pasoja, sipas fjalëve të këtyre shkencëtarëve, do të jenë katastrofike dhe numri i viktimave do të llogaritet me miliona. Njerëzit, jo vetëm do të mbeten pa drita, por do të dalin jashtë përdorimit ujësjellës dhe arteriet termike, do të ndalojnë punën spitalet dhe do të

*Sa mirë do të ishte që fusha magnetike Diellore, të mjekonte mendjet "njerëzore" që janë antinjerëzore, genet "njerëzore", që vdesin për pak luftë klasore!!*

paralizohet ekonomia e vendeve më të zhvilluara industriale. Pse vendet e zhvilluara? Sepse ato kanë konsumin më të jashtëzakonshëm të energjisë elektrike. Kështu, edhe krizën e sotme ekonomike më shumë e ndiejnë vendet e zhvilluara, (sepse kanë ekonomi), sesa vendet e pa zhvilluara, (që s'kanë ekonomi), sikundër jemi ne, të fundit në Evropë. Planetit do t'i duhen disa dekada për të dalë nga ky kolaps energjistik. Për fat të mirë, shkencëtarët rusë nuk e shikojnë gjendjen kaq të zymtë. Ata pohojnë se aktiviteti Diellor ndryshon në bazë të një cikli 11 vjeçar, (më saktë 11, 22, 33 vjeçar, shënimi im), dhe në cikle dyshekullore. Shpërthimi që pritet jo më 2012, por në fillim të vitit 2013, do të kalojë në sfondin e një aktiviteti Diellor minimal, që do të thotë, se nuk mund të ketë pasoja

aq të rënda sa ato që priten nga Akademia Amerikane e Shkencave.

Shpërthimi do të ishte fatal edhe për rusët, nëqoftëse ai do të ndodhte në kohën e një aktiviteti normal maksimal të Diellit. Tani do të bëjmë fjalë për disa informacione të tjera, që mund të zvogëlojnë, sado pak, shqetësimin apo frikën tonë. Është e vërtetë që 21 dhjetori 2012, është data, në të cilën, sipas disa interpretimeve shumë të përhapura kohët e fundit në internet, botime dhe dokumentarë televizivë, (pra burime jo rigorozisht shkencore), do të ndodhë në Tokë një formë kataklizme. Formë kataklizme!! Kjo pritshmëri, bazohet e gjitha në një kalendar të një civilizimi të njohur. Bëhet fjalë për të famshmin kalendar të Majave. Sipas tij, 21 dhjetori 2012 do të jetë fundi i Botës, ose së paku fundi i kësaj ere dhe nisja e një epoke të re. Ky njoftim nuk ka bazë shkencore. Ajo është një profeci, si gjithë profecitë e tjera të gabuara, prandaj nuk mund të jetë burim shqetësimi. Në vitin 2012, jo më 21 dhjetor, por më 22 shtator, shkencërisht pritet të ndodhë vërtet diçka e lidhur me aktivitetin diellor dhe lëvizjen e planetëve, (trazira suplementare, shënimi im), por ky është një aktivitet i pritshëm dhe i paralajmëruar, që nuk ka lidhje me "profecinë e Majave." Çfarë do të ndodhë? Sipas disa shkencëtarëve në shtatorin e 2012 do të ketë një kulm jo të zakonshëm të aktivitetit diellor, që mund të shoqërohet me krijimin e disa zonave magnetike të rrezikshme, por sipas tyre, kurrësesi nuk mund të flitet për fundin e Botës, apo teza të tjera të ngjashme me të. Pseudoteoria për "21 dhjetorin 2012" ka marrë dhenë në kulturën popullore edhe për shkak të aplikimit të saj, në disa serialë televizive shumë të ndjekur. P.Sh, në pjesën e fundit të serialit fantastiko-shkencor "X-Files", tregohet se 22 dhjetori i vitit 2012-të (pra një ditë pas 22 dhjetorit të famshëm), është data e planifikuar nga një popull alienësh (jo tokësorë), për pushtimin e Tokës. Teorikisht, si ne edhe jashtëtokësorët mund të fluturojnë në Kozmos. Profecia antishkencore e pushtimit të Tokës nga 5 apo 55 alienë nuk shqetëson as fëmijët, as kukullat e tyre, ashtu sikundër parullat e socializmit me gurë të zbardhur me gëlqere, nuk kruajnë asnjë njeri në demokraci, përveç ndonjë pseudoartisti, që merret me gjurmën e gurëve dhe jo me ujkun e

# Apokalips apo "apokalips"?

## Përmasat e shembjes së botës?

propagandës së fuqishme të kohës së diktaturës. Edhe Roland Emmerich, regjisor shumë i njohur për filmat me skenar katastrofash, ka gati një film me titullin e shkurtër "2012".

Ky film pritej të dilte në kinematë e botës më 13 nëntor 2009. Mbase ka dalë. Ky është film fantastiko-shkencor, përmbajtja e të cilit nuk ka përse të jetë e vërtetë. Me sa duket, edhe artistët e huaj, duke qenë kushërinj të parë me artistët shqiptarë, të flakëruar nga pasioni i artit të tyre, e venë veten mbi shkencën e rrëshqasin bukur e lehtësisht, tangjencialisht me të. Kjo do të thotë që në shkrimet për këtë problem, duhet ta përqëndrojmë vëmendjen në konkluzionet e shkencëtarëve dhe jo në interpretimet artistike të filmave fantastiko-shkencorë, jo në pohimet jo shkencore të internetit, jo në botimet jo shkencore, jo në dokumentarët televizivë jo shkencorë, etj.

Duke "biseduar" me njerëz të përfytyruar ose më mirë me veten time, mund të vazhdojmë shkrimin tonë. Ku e gjeti apo do ta gjejë Dielli energjinë e paparashikuar nga shkencëtarët për shpërthimet e fundit që ndodhën apo do të ndodhin? Dikush, duke u mbështetur në teorinë e reaksioneve termobërthamore më tha: 70% e masës së Diellit përbëhet nga hidrogjeni, 29% nga heliumi dhe 1% nga 70 elementë të tjerë kimikë. Mbase janë KRIJUAR KUSHTE që atomet e dy elementëve të lehtë, përveç çifteve të atomeve të hidrogjenit, të bashkohen e të japin një element kimik të tretë, padyshim me një defekt mase më të madhe, se defekti i masës së atomeve të hidrogjenit.

Ky defekt mase, duke u shumëzuar me katrorin e shpejtësisë së dritës, sipas formulës  $E=mc^2$  të Ajnshtajnit, jep energjitë mbikolozale të Diellit, shkaktare të shpërthimeve të

fundit. Ky arsytim bie poshtë menjëherë, porsa të shtrojmë pyetjen: Pse nuk ndodhi ky reaksion më parë? Mbase më i pranueshëm do të jetë arsytimi sipas të cilit, sasira më të mëdhaja çiftesh të atomeve të hidrogjenit, t'i jenë nënshtruar reaksionit termobërthamor. Akoma më shumë ngjan me përrallën mendimi sipas të cilit, ndonjë trup qiellor i sistemit Diellor ose jashtë tij, t'i ketë shpëtuar vigjilencës së shikasve të shkencës së astronomisë, të jetë futur në gjirin e Diellit dhe atomet e elementëve të lehtë të tij, mbase edhe me ato të Diellit, t'i jenë nënshtruar reaksionit termobërthamor.

Mbretëria qiellore e Krishtit dhe Muhamedit që do të vinte tek ne, mesa duket mbeti rrugës në utopinë e saj. Komunizmi dhe doktrina e tij, nëpërmjet pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit, do t'i vinte njerëzit në kushte shoqërore të njëjlojta, pa shfrytëzim të njeriut nga njeriu, do t'i bënte të barabartë në çdo gjë, në shpërndarjen e prodhimit, në arsim, në barazinë e plotë midis burrit e gruas, etj. Në shoqërinë komuniste, e cila do të ishte si një kufi i përpiktë i sipërm i paarritshëm i etapave apo shkallëve të njëmbasnjëshme të socializmit si PROCES, nuk do të kishte shtet, nuk do të kishte klasa, nuk do të kishte luftë klasash, etj, etj. Komunizmi do të ishte shoqëria e bollëkut ku çdo njeri do të punonte sipas mundësive e do të shpërblehej sipas nevojës, shoqëria ku një do të ishte për të gjithë e të gjithë për një, shoqëria ku interesi personal do të vihej poshtë interesit të përgjithshëm, etj, etj. Pra shoqëria komuniste do të ishte identike me shoqërinë e Mbretërisë qiellore të Krishtit e Shën Marisë. Ndërtimi i kësaj shoqërie, për dhjetra arsye që unë i kam trajtuar në librin tim "Jetë me luftë", mbeti UTOPIKE. Ajo ecuri ishte utopike, sepse në fund të fundit, në rrugën e ndjekur, SHOQËRIA PO VIDHTE VETVETEN; njerëzit e posteve,

nga më të lartat tek më të ultat, po vidhnin frutin dhe djersën e popullit, kooperativistët, po vidhnin prodhimet e tyre në kooperativë, punëtorët, po vidhnin prodhimet e tyre në punishte, fabrika, etj, etj. Endrrën e bukur utopike komuniste Lenini e shihte si pushtet të sovjetëve, plus elektrifikimin e vendit, pra elektrifikimi i vendit do sillte lumturinë e tij. Shpërthimet Diellore që presim do të na lenë pa energji elektrike, pra do zhdukim elementin bazë të mirëqënies të jetës njerëzore. Kjo do të thotë se mendjendriturit e shkencës e politikës shqiptare, duhet të shqetësohen për masat që duhen marrë para e pas shpërthimit Diellor, për të zvogëluar numrin e viteve të dekadave të reabilitimit të planetit tonë, vendit tonë.

Përsa u përket sovjetëve, ato kanë qenë si Këshillat tona popullore të socializmit, që zhvillonin luftën e klasave, simotra të organeve të sotme vendore. Pluralizmi ynë është pa ideale njerëzore, ai është katandisur në luftë, pse mos themi klasore, kryesisht, midis dy grupimeve popullore të dy partive kryesore. Pluralizmi i vërtetë amerikan-evropian, karakterizohet nga përpjekjet që i shërbejnë shoqërisë njerëzore, përtej të MAJTËS dhe të DJATHTËS. Vetëm injorantët nuk e kuptojnë rëndësinë e veprimtarisë përtej së majtës e së djathtës. Idiotësia e tyre, që u duket mençuri, mishërohet nga kutia e pesë sardelkave, e pesë cironkave, e pesë kotelkave, e pesë këlyshkave mashkullore të Fatos Nanos, të cilët me ççoçërrllëkun e tyre, jo vetëm venë në dyshim vlerat e përpjekjeve përtej së majtës e së djathtës, por e paraqesin atë edhe si të dështuar, duke pranuar kështu, luftën e klasave të tipit të ri. Politikanët le të merren me zgjedhjet e 2013-tës, 2021-it e të 2701-it po të duan, por në asnjë mënyrë nuk mund të jenë invariantë ndaj shpërthimeve të

pritshme Diellore. Sa mirë do të ishte që fusha magnetike Diellore, të mjekonte mendjet "njerëzore" që janë antinjerëzore, genet "njerëzore", që vdesin për pak luftë klasore!!

Dikush, për problemin e shpërthimeve Diellore, na fton të mbështetemi tek ndërkombëtarët, të cilët, me qëndrimet e tyre ndaj popullit tonë, nuk kanë përse të krenohen. Për luftimin e pasojave të shpërthimeve Diellore, ndihma e tyre mund të vijë "dy-tri" ditë para shpërthimit e që vetëkuptohet se ajo nuk do të ketë asnjë dobi.

Ndërkombëtarët, edhe me para, nuk mund të mposhtin goditjet e stuhive magnetike Diellore. Para për devijime?!!

Në kuadrin e këtij shkrimi me përmbajtje tepër serioze, le ta marrim shpirtin me të mirë, duke u futur në humorin e shkollës "Portokalli", nëpërmjet paralelizmave të Stambollit që digjet e prostitutkave mashkullore apo femërore që krihen:

1- Shpërthimeve Diellore para 28 qershorit, me flakërimat e fushatës elektorale para zgjedhjeve të asaj dite;

2- Periudhës dinamike pas zgjedhjeve të 28 qershorit dhe zhvillimeve jo fort shpërthyesë në gjirin e Diellit;

3- Shpërthimeve kolosale të Diellit në fund të vitit 2012 ose në fillim të vitit 2013, me shpërthimet elektorale të zgjedhjeve të pritshme para eksplozionit Diellor të vitit 2012 apo 2013. Më ngushëllon, për më tepër më gëzon fakti, që data amerikane e shpërthimit, nuk përputhet me datën ruse të tij. Ato data e "Përjashtojnë" njëra-tjetrën, sepse shpërthimi nuk thuhet se do të ndodhë në të dyja datat, si rrjedhim njëra prej tyre duhet të jetë e gabuar. Cila? Probabiliteti është 50% për njërën e 50% për tjetrën. Meqë njëra është e gabuar, me siguri, atëherë për fatin tonë të mirë, qofshin të dyja të gabuara!!!...

Ishalla parashikimet shkencore, kthehen në thashethemnaja shkencore, gjë që për ne, që besojmë tek shkenca, s'ka mundësi të ndodhë.

Thuaj po deshe: lum kush të rrojë!

**Petro Prifti**

*Pogradec, më 28 nëntor 2009*

Të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut

## Dhuna kundër grave kërcënon zhvillimin dhe paqen

Deri në vitet '80-të dhuna kundër grave nuk ka qënë temë e Kombeve të Bashkuara. Kurse sot ekziston një i ngarkuar i posaçëm dhe të drejtat e grave janë përfshirë ndërkohë në disa deklarata. Dhuna kundër grave kërcënon zhvillimin. Ky ishte mesazhi i Kombeve të Bashkuara, që sekretari i Përgjithshëm, Ban Ki Mun, dha me rastin e ditës ndërkombëtare për mënjanimin e dhunës kundër grave. Aktet e dhunëshme të grave dhe vajzave në të gjithë vendet e botës nuk krijojnë vetëm vuajtje, por shkaktojnë mungesë stabiliteti dhe rëndojnë përpjekjet për paqe, tha Ban Ki Mun. Nuk ka qënë gjithnjë kështu, sepse tema e dhunës kundër grave, sidomos në lidhjet bashkëshortore, nuk ka qënë temë e sistemit të Kombeve të Bashkuara deri në vitet tetëdhjetë. Së pari, organizatat e grave bënë të qartë se të drejtat e

njeriut nuk marrin parasysh sa duhet realitetin e jetës së përditëshme të grave. Ato përfshijnë marrëdhëniet midis shtetit dhe qytetarëve dhe jo jetën private. Kështu burrat mbrohen nga shteti para torturave me motive politike, kurse gratë që keqtrajtohen nga burrat e dhunshëm nuk mbrohen. Komisioni i Kombeve të Bashkuara për zbutjen e diskriminimit të grave ( CEDAW ) e pranoi kritikën dhe e përcaktoi dhunën e kësaj natyre si diskriminim gjinor. Por lëvizja ndërkombëtare e grave arriti për herë të parë sukses në Konferencën e të Drejtave të Njeriut në Vjenë në vitin 1993. Nën moton "Të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut", ato përfaqësuan atje problemet e tyre dhe Asambleja e Kombeve të Bashkuara nxori në dhjetor të 1993-shit një deklaratë të rëndësishme. Për herë të parë dhuna e ushtruar kundër grave në familje, në

shoqëri apo edhe nga shteti u përkufizua në mënyrë të përgjithshme, duke përfshirë në të edhe përdhunimin në martesë, si dhe gjykimin e organeve gjentiale të grave. Përveç kësaj, deklarata thotë se dhuna kundër grave është formë e shprehjes së shpërndarjes së padrejtë historike të forcave midis grave dhe burrave, që ka çuar në sundimin dhe diskriminimin e grave nga burrat, duke u hequr grave shanset e barazisë. Në vijim, Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut krijoi postin e së ngarkuarës së posaçme për çështjen e dhunës kundër grave. Nëpërmjet analizimit të saktë të dhunës në martesë dhe familje bëhet e qartë se edhe përparimi i grave në politikë, arsim dhe profesion nuk e mënjanon domosdoshmërisht pabarazinë gjinore. Shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, që luftojnë për

### RASTET

*Aktet e dhunshme të grave dhe vajzave në të gjithë vendet e botës nuk krijojnë vetëm vuajtje, por shkaktojnë mungesë stabiliteti dhe rëndojnë përpjekjet për paqe, tha Ban Ki Mun.*

arritjen e barazisë gjinore, ndihen të konfirmuara në përpjekjet e tyre se është e pranueshme dhuna kundër grave. Kështu, vitin e kaluar filloi fushata e Kombeve të Bashkuara "Unite to End Violence Against Women", ( Bashkohuni për t'i dhënë fund dhunës kundër grave ), e cila vazhdon deri në vitin 2015. Përmes kësaj fushate kërkohet që shtetet të nxjerrin ligje efektive, të zbatojnë plane aksionesh dhe të marrin masa preventive kundër: dhunës në familje, përdhunimit dhe martesës së detyruar, kundër marrëdhënieve seksuale të padëshiruara dhe të pambrojtura që bartin rrezikun e sëmundjes së sidës, kundër gjykimin gjental të femrave, kundër vrasjeve për shkaqe nderi, kundër prostitutimit të detyruar dhe skllavërisë, si dhe kundër dhunës seksuale në konfliktet e armatosura.

## 16 Ditë Aktivizëm kundër Dhunës ndaj Gruas

Shoqata "Unë, Gruaja" (UG) në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje, Bashkia Pogradec, organizoi aktivitetin përmbyllës të Fushatës 16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës ndaj Gruas. Kjo fushatë nisi më 25 Nëntor e cila është Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Gruas dhe u mbyll më 10 Dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Fushatën e parë, shoqata UG e ka realizuar në vitin 2000, dhe tani kjo është kthyer në një aktivitet traditë. Pa modesti themi se, UG ka qënë ndër të parat shoqata në Shqipëri, për të mos thënë e para, që ka organizuar këtë fushatë.

Motoja e fushatës 2009 ishte Angazhohu-Vepro-Kërko: Ne mund t'i japim Fund Dhunës ndaj Gruas! Gjithashtu, Viti 2009 është 10 vjetori i njohjes zyrtare nga Shtetet e Bashkuara të 25 Nëntorit, si Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas. Fushata e këtij viti iu dedikua grupeve apo individëve të nderuar që janë **angazhuar** për të tërhequr

vëmendjen globale në luftën kundër dhunës ndaj gruas. Inkurajon çdo njeri, pavarësisht mundësisë, të **veprojë** për t'i dhënë fund dhunës, dhe të **kërkojë** llogari për të gjitha premtimet që janë bërë për eliminimin e dhunës ndaj gruas.

Ne ndihemi dhe jemi pjesë e këtij grupi dhe në këtë kuadër kemi realizuar një sërë aktivitetesh, si publikimin e një sërë materialeve publicitare, shpërndarjen e tyre në qytet e fshat, por edhe më gjerë në Korçë, Ersekë, Gjirokastër e Përmet. Janë realizuar takime me grupe grash dhe nxënës nëpër shkolla apo vizita pranë shoqatës UG. Mjaft nxënës të shkollave të mesme kanë shprehur dëshirën për të vizituar ambientet tona dhe për të marrë më shumë informacion për aktivitetin tonë. Me rastin e 16 Ditë Fushatë, nxënësit e vitit të tretë të shkollës së mesme të përgjithshme "Gjergj Pekmezi" vizituan shoqatën UG. Znj. Eleni Jajçari bëri një prezantim të shkurtër të shoqatës dhe më pas fëmijët bënë pyetje të ndryshme, ndër të cilat veçojmë:

-Sa kohë keni që funksiononi si UG?

-Cila është ndihma që u jepni grave të dhunuara?

-A jeni ndier ndonjëherë të kërcënuara, nga bashkëshortët e viktimave?

-A janë zgjidhur çështjet që keni trajtuar?

-A janë të lirshme gratë, kur flasin për problemet e tyre familiare?

-A bëni dallime racore?

-Ju flisni për barazi gjinore, por mbani emrin UG. Pse? Pse nuk keni vënë një emërtim që të përfshijë të dyja gjinitë?

-Sepse ne kemi parë që roli i gruas është më problematik në shoqërinë tonë. Ne kërkojmë të ecim krah për krah me burrat, dhe ata të na mbështesin. Dhe kjo mbështetje është më e dukshme kur ata bashkohen me Unë, Gruaja.

E veçantë për Fushatën e këtij viti ka qënë realizimi dhe shfaqja e pjesës teatrale "Me Maska, Pa Maska" nga trupa e Teatrit Shëtitës. Kjo pjesë teatrale është shfaqur në fshatra të ndryshme të rrethit si

Tushemisht, Hudënisht, Pirg për t'u finalizuar më pas në Pogradec, tek Teatri i Kukullave. Ajo ç'ka është e rëndësishme të përmendet është se kjo trupë, nëpërmjet komedisë i prezanton publikut Ligjin "Për Barazinë Gjinore" dhe atë "Për Masat ndaj Dhunës në Familje". Në këtë mënyrë ne synojmë jo vetëm argëtimin e publikut por edhe informimin e tyre.

*Zyra Arsimore Pogradec dhe një numër i konsiderueshëm mësuesish e drejtues shkollash kanë qënë pjesë e këtij procesi në shpërndarjen e materialeve publicitare si dhe materialeve informuese. Po kështu edhe personat e kontaktit pranë UG që vazhdimisht, por veçanërisht, në ditët e fushatës mundësuan informimin e komunitetit në zonat rurale. Për publikimin e disa prej materialeve publicitare një ndihmë të konsiderueshme ka dhënë Banka Popullore, Dega Pogradec si edhe shtypshkronja DIJA-Pogradeci e cila është dhe mbështetëse e përherëshme e aktiviteteve tona.*

Nga Muharrem Xhaxho

Poeti Ylber Merdani ka filluar të shkruajë që në moshën rinore, madje janë disa prej poezive të tij antikomformiste të shkruara në vitet '60 si; poema "Të dënuarve", poezitë; "Motrës dhe vëllait për ditëlindje", "Malet", etj që do të bëhen shkak për dënimin e tij. Ka shkruar poezi në burg, në interesim dhe vazhdoi të krijojë. Zëri poetik i Ylber Merdanit, si një zë i sinqertë dhe i çiltër ka si tipar thjeshtësinë dhe qartësinë. Nuk gjen në poezinë e tij mllef që shkon në tejskajshmëri për shkak të vuajtjes në diktaturë edhe pse ka një gulsh të brendshëm, kurrësesi nuk e shpreh dhunshëm. Merdani nuk është prej atyre që kërkuan shpagim, sepse vendin e kësaj në poezi e pat zënë ndjesia e së arsyeshmes. Ajo që të bën të vëmendshëm, është gjetja e forcës për t'u përballur me të vështirën.

Y.Merdani është poet i komunikimit intim, i besimit tek e ardhmja, veçanërisht, sepse ai e shihte atë si shenjë të gjendjes shpirtërore ndryshe. Këtë filozofi do ta gjejmë në mënyrë të sintetizuar edhe tek një poezi me katër vargje; "Dua të qesh, për mua çupa qesh./ Dua të loz, për mua djali lot./ Për të mallkuar, gruaja nuk rresht./ Hakmarrjen ta kam lënë ty, o zot". Jeta e mundimshme i ka dhënë poezisë një përmbajtje të veçantë që e shpreh si një brengë e pakënaqësi, që shqiptohet me një tonalitet të trishtë dhe jo si britmë, pra është ndjesi. Poezia përmban fillin e së keqes, shpesh është metaforë e jetës së trishtueshme. Poeti pranon dashurinë dhe humanizmin si një ekuilibër shpirtëror, i domosdoshëm. Herë pas here hyn në komunikim me lexuesin dhe shpesh bën pyetjen; "A jam...poet vërtet? Ndonëse ka filluar të shkruajë herët, kërkon që poezia e tij të ndikojë në emocionalitetin e lexuesit. është ky lexues që do të gjejë në poezi një shpirt të brengosur; "U ngashënjyjet ju dhe derdhet lot/ E ndërsa unë për vete s'qava dot/ e jo se ndjenjat, shpirti kanë vdekur./ Paksia janë topitur, kanë fjetur;/.

Diktatura ia preu burimet mendësore, jetësore dhe ia bëri jetën të vështirë. Ndërsa në pikëpamje shpirtërore ia tendosi nervin poetik dhe i nxit mundësinë e shprehjes së brengës nëpërmjet vargut poetik.



*Merdani nuk është prej atyre që kërkuan shpagim, sepse vendin e kësaj në poezi e pat zënë ndjesia e së arsyeshmes. Ajo që të bën të vëmendshëm, është gjetja e forcës për t'u përballur me të vështirën. Y.Merdani është poet i komunikimit intim, i besimit tek e ardhmja*

## Zëri poetik i dhimbjes në poezinë e Ylber Merdanit

Pra, në se poezia e Merdanit të fton për lexim, të njohësh dhimbjen prej absurdit, të detyron edhe të mendosh. Poezia është jeta e mbërthyer në morsën e shtrëngesave të pafundme shpirtërore dhe fizike, është pentagrami i jetës dhe shpirtit të tij. Këtë ndjesi mund ta hetosh e ta shqiptosh si një thirrje, por vetë poeti ka një zë tjetër më të qetë i cili e fsheh domethënien dhe e detyron lexuesin të hyjë në lojën e imagjinimit: Për poetin, poezia ka qënë një balsam në situatat më të nderlikuara e të vështira të jetës së tij fizike e shpirtërore. Duke komunikuar nëpërmjet vargut, është ndjerë më i lehtësuar prej ankthit të herëpashershëm. Nota të tilla parashikojnë vëllimet poetike: "40 letra dashurie", "Klithma në shkretëtirë", "Puhiza endacake", "Humnerat e zhgënjimit", "Ja vdekje, jaliri", poema "Për Devollin", ndërsa vëllimi me poezi të zgjedhura "Shpresa e blertë", është botuar prej entit "Flaka" në Maqedoni. Vargu poetik i Merdanit shpreh pastërtinë dhe krenarinë e shpirtit: "Paçka se s'janë të bukur/ Në rrugë/ të eni krenarë/, poezia "Vargjet e mia". Përballja me një realitet të ashpër, me një diktaturë të egër, në internim e burgim, do të njihnin një tjetër shpërthim në zërin e poetit. Kthimin pas një çerek shekulli burg e internim, do ta japë me vargje tepër mallëngjyese dhe të dhimbshme:

"Ngatërrohem, rrëzohem, përbysem diku... Mes kolles filloj të nem/...Po kisha dhe prindër, pa kisha shtëpi./ Nga shokët askush s'paska mbetur/ Kaloj kësaj rruge i huaj tani/ i thinjur, i kërrusur, i tretur/ .Zëri poetik i subjektivit lirik, është zë i formuar në mjedisin ku fisnikëria kishte rrënjë të lashta, ku zemërgjerësia, besnikëria, shpirti human, ishin cilësi të lindura e të trashëguara, njëkohësisht të manifestuara në kohë të ndërkëmbyera, pra si në kohë të mira dhe të vështira. Edhe poeti mendon, që këto virtyte të mos zbehen, pra ai synon tek ringjallja e fjalës së mirë. Tek poezia e Merdanit, shpesh ankthi, trishtimi, gjenden të pranishëm së bashku me ëndërrën, ndonëse me një besim të vakur tek e ardhmja. Edhe pse poeti nuk flet drejt për së drejti. Duke folur për një dukuri të zakonshme, si ajo e shkëputjes së trupave të zjarrtë qiellorë që zhgarravit nëpër qiell, sajohet metafora e shpresës si pritshmëri. Poeti kishte një ëndërr që nuk i kishte vdekur dhe një bindje të pakthyeshme mbështetur në korelacionin stinor; se mbas dimrit, vjen pranvera. Shpresa është bashkëudhëtare, ajo është një ngushëllim për brengën. Herë këto dukuri ndërkëmbehen me njëra-tjetrën, ndërsa trishtimi është real, ëndërra dhe shpresa, janë imagjinare. Trishtimi vjen prej përditshmërisë, prej jetës së jetuar.

"Fliste shpirti shpresëdhënës/ Gjith me yjet rrugëtare/ Fshtësisht i fliste hënës./ Që nga toka çehrevrarë/. Ndërsa realiteti si trishtim është i hapur që vështrohet apo imagjinohet. Shpresa mbetet disi e fshehur, e padeklaruar, por ngacmuese dhe e pritshme. Kjo shpresë në poezi, merr fizionomi njeriu që përmes vështirësive dhe sakrificave të mundimshme, sillte zërin e lirisë si një shpëtimtare që ka marrë mbi vete barrën e vështirë. Herë kjo merr pamjen e një fenomeni të pakapshëm, si diçka e jashtëzakonshme, qiellore. Edhe nëse lind një dashuri, më pas ajo do të zhndërohet në një trishtim; "Ti më takoje shpesh nëpër vegime/ Dhe unë nëpër ëndërra të kërkoja...Ty nuk të lanë, të mbytën internimet/ Rinia ime burgjeve vrapoi... Pra, dashuria shndërohet në një dramë. Për poetin, dashuria është një mall i shenjtëruar. Dashuria është dallgë e brengë, kaltërsi e vranësi, mall e zjarr, por edhe ankth e trishtim. Në përballje me pengesat, vështirësitë dhe ligësitë e pamëshirshme, poeti, tëk harmonia qiellore gjen qetësinë shpirtërore. Nga kjo lojë e bukur e imagjinatës poetike, kanë dalë vargje të tilla; "E një dëshirë e çmendur më ka kapur,/ Të shkoj atje, tek Hena krahëhapur;/ Në është aq e pastër sa e di,/. Tek pastërtia e saj do të bëhem fli./ vijon në numrin e ardhshëm

*Ndaj doktor Mistos jemi të gjithë jemi mirënjohës*

# Respekt dhe dashuri për Dr. Miston

*Nga Tomi Mato*

Të dy kemi lindur me fat. Në atë kohë kur brezi ynë hipte mbi urën e Volorekës e përballej me tabelën “Zonë kufitare! Ndalim kalimi!”, ne kaptuam kufirin shtetëror. Ai vazhdoi studimet e larta për mjekësi Bukuresht-Rumani, mua m'u akordua bursa për të vazhduar studimet në Akademinë e Arteve të Bukura, Pragë-Çekosllovakia. Ai i përfundoi në vitin 1954. Koiçidencë, kur Mistua po ktheheshe në atdhe, unë po vija për pushime verore. U takuam në kuvertën e vaporit komod rus “Billi Ostrov”- (Ishulli i bardhë). Gjatë pesë ditëve dhe mbrëmjeve duke lundruar mbi ujërat e detit të Zi, “Marmara”, “Egje” dhe “Adriatik” këmbenim mendime rreth ëndrrave që na presin në jetë. Ai ishte entuziast mbi nivelin shkencor që kishte arritur arti i mjekimit në Rumani. E ndiente veten të aftë për të mjekuar dhe shëruar jo vetëm ata pacientë që kishin probleme patollogjike, por edhe probleme të tjera në tru. U befasua kur i kallzova se mjekësia çekosllovake në metoda diagnostikimi dhe kurimi moderne ka ecur përpara.

përpara bisedën:

-Mjekët çekë tregonin kujdes për pacientët shqiptarë. Thashë të vërtetën?

-Shumë

-Konkretisht. Kallzomë një rast. Vaporit çante dallgët e “Detit të Zi”, ne të ulur në kuvertë admironim romantikën e natyrës rreth e qark. Unë e vazhdova dialogun.

- Po të jap një shembull. Naum



Kërshtëria e detyroi të më zhbijojë: - Nga je mirëinformuar mbi nivelin shkencor të mjekësisë çekosllovake, o regjisor?

I kallëzova:

- Jam në një organizatë të rinjsh shqiptarë që studiojnë për mjekësi. Kam shoqëri me studentët Veli Toto, Sali Dedej, Luan Laro, etj. Ata më informojnë për çuditat që shikojnë nëpër klinikat.

Veç kësaj shumë kuadro të larta që vijnë në Pragë për t'u mjekuar i kam shoqëruar, diagnostikuar dhe shtruar nëpër klinikat. Nga Pogradeci kanë ardhur Todi Kokoneshi (sekretar partie rrethi) dhe Avni Vërçuni (Kryetar K.E.K.P. Rrethit). Mistua e shtyu

Gëdeshi, sekretar i ambasadës tonë kishte probleme serioze kardiologjike. U operua. Isha në dhomë. Hyri mjeku dhe i dha kurajo:

-Shoku Naum nga fytyra sot dukesh që je më mirë se dje, të siguroj që nesër do të jesh më mirë se sot. Së shpejti do dalësh i shëruar si top. Përktheva. U ngashërye, ia shtrëngoi dorën dhe më tha:

-Miku im Tomi, Dr. Lukashi të kuron më mirë me fjalë se me ilaçe. Ai u shërua. Mugëtira e mbrëmjes na zuri në Dardanelet. Stambolli filloi të llapsë nga dritat. Sipër ujit lundronin varka me vela, lopata dhe motorskafë. Në tavernat bekrinjte dhe qeflinjtë pinin, nëpër tavolina ju vinin orkestrina dhe këngëtarë për

t'i dëfryer. I shikonja këto skena romantike dhe i thashë Mistos:

-Më kujtohet në kohën e Zogut, Italisë, e mbas Çlirimit të rinjtë pogradecarë bënë tava me peshk, mirrinin bukkitë me verë, kitarat, hipnin nëpër varka dhe këndonin, hanin dhe pinin. Tani varkat pa u fshehur dielli prapa maleve të Mokrës i mbyllin me çelës “Elzet”.

-Sa kaluamë Stambollë më pyeti Mistua:

-Më intereson të di, ka ndonjë kujtim tjetër nga marrëdhëniet e mjekëve me të sëmuret që vinin nga Shqipëria ose në marrëdhënie me studentët shqiptarë. Si u mendova vendosa dhe tregova diçka që e kisha dëgjuar nga Dr. Lukashi dhe studentët shqiptarë që e zinin shpesh në gojë. E pyeta:

- Dua të të tregoj një histori, po kam frikë, mbase e di?

-S'ka gjë. Përsëritja është nëna e dijes. Filloje. Ia plotësova dëshirën.

- Me Dr. Lukashin u miqësova. Herë mbas here këmbenim mendime rreth artit dhe mjekësisë. Një herë guxova dhe i thashë:

-Gjithë të sëmuret që kanë ardhur për t'u mjekuar në spitalet e Pragës kanë mbetur të kënaqur nga

sjellja e mjekëve me të sëmuret. Qeshi dhe m'u përgjigj:

- Ka të ngjarë që ta kenë, njohin çelësin që hap të fshehtat e çdo sëmundjeje. E kam fjalën për “Betimin e babait të mjekësisë botërore, Hipokratit. Na kanë lënë si testament. E ke dëgjuar? I turpëruar tkurra supet dhe lojta kokën.

-Di pak, fare pak. Mistua e njihte, por u soll sikur s'e dinte. Më pyeti:

-Me qënë se do fillonte t'i shërbente shëndetit të popullit, të ka ngelur në çetelen e mendjes ndonjë këshillë nga “Betimi i Hipokratit”. Atë që dija ia thashë.

- Jam çuditur si kanë ardhur brez pas brezi deri në ditët tona këshillat

e “Betimit të Hipokratit! Dr. Lukashi më tha se në vitin 1948 qënka mbledhur në Gjenevë “Organizata Shëndetësore Botërore dhe paska cituar midis të tjerave këto këshilla... Ai ngriti dorën. Pushova. Filloi ai të tregojë:

- E para, Hipokrati është betuar: Mjeku dhe pacienti duhet të kenë njohuri mbi të drejtat themelore në rast sëmundjeje. E dyta, mjeku me të filluar profesionin, të gjitha dijenitë e tija duhet t'i verë në shërbim të pacientit. E treta, mjeku i ri duhet të ketë respekt e mirënjohje për mësuesit e tij. E katërta, kolegët e tij duhet t'i ketë si vëllezër, t'i respektojë dhe bashkëpunojë. E pesta, t'i përkushtojë kujdesin më të madh të sëmurit, ditë e natë, etj. Ia shtrëngova dorën.

- Më vjen mirë që paske dijeni mbi “Betimin e Hipokratit”. Mistua më tha: Gjithë këto mësimë do përpiqem t'i vë në jetë me pacientët që do të më kërkojnë ndihmë. Dr. Mistua u emërua nga Ministria si mjek në Korçë. E dinte se bashkëqytetarëve të tij deri atëherë u kishin shërbyer mjekët, Filip Papajani, Thoma Kondi, Ali Babaliu. Asnjë pogradecar s'kish qëndruar në vendlindje. Mbas 6 muajve ai transferohet në vendlindje me detyrën mjek patollog dhe drejtor i spitalit “Rural”. Pra Dr. Misto Markua është doktori i parë pogradecar që iu shërbeu me zotësi, dashuri dhe devotshmëri bashkëqytetarëve dhe fshatarëve.

Për të treguar meritat e tij si mjek i shquar këto ditë takova kolegët që punuan për të, Dr. Teodor Jorgonin, Dr. Ramadan Mukollarin (kohë më parë dhe mjeken Kristina Llakmani, tani në Pragë). Që të tre e vlerësuan si mjek të zot kopotent, me kulturë të gjerë mjekësore. Mbi të gjitha studioz. Sa herë dyshonte për të diagnostikuar të sëmurin, hapte literaturën profesionale në gjuhën rumune dhe italyane. Meqënëse mungonin specialistët bëri një kurs 6 mujor për kardiologji. Kishte raste kur ndërhynte dhe për fraktura kirurgjikale (duar, këmbë të thyera, etj).

Në spitalin “Rural” s'kishte mjek

*Dr Mistua nga viti 1954 e deri sa doli në pension 1990 ju shërbevi të sëmureve për tua lehtësuar dhimbjet e zgjatur jeten*

## vijon nga faqja 12

roje natën. Kur kërkonte ndihmë akute ndonjë i sëmure, infermieri vinte në këmbë dhe ngrinte nga gjumi. Dr. Mistua vinte me vrap. Ja jepte ndihmën e nevojshme deri sa e qetësonte.

-Si me shaka e ngacmova Dr. Jorgonin:

-Sot disa mjekë të pandërgjegjshëm e turpërojnë mjekësinë duke u marrë lekë pacientëve. Dr. Mistua merrte rryshfet? Protestoi me ndërgjegje të pastër:

-Në kohën tonë nuk njihej fjala "Korrupsion". Besomë, ai as kafe nuk vinte të pinte. Ishte njeri i pastër: Po të merrte para nën dorë do kishte bërë ndonjë vilë, por jeton në shtëpitë që i bëri i ati, Sotiri. Për ta ekzaminuar më mirë figurën e tij nga sëmundja e korrupsionit, në atë kohë, pyeta dhe tre infermierë që kanë bashkëpunuar më Miston, Vasillaq Bushon (Laqon), Vasfi Caken dhe Kostaq Çobanin.

Veterani i infermierëve Laqua më tha: Dr Mistua ka qenë mjek i zoti, i përgjithshëm, me aftësi profesionale, përcaktonte sëmundjen e pacientit dhe mjekonte me kompetencë. Nuk mbaj mend

# Respekt dhe dashuri për Dr. Miston

të ketë bërë ndonjë gabim. Ndërsa Kostaq Çobani më tregoi këtë histori: "Një djalë në fshatin Zagorçan përcolli një luçkë të vogël metalike. Barku ju enjt. Prindërit vendosën ta shpinin në Korçë, ta operonte Dr. Polena. Mistua nguli këmbë. Mos kini merak, do t'ia nxjerr unë me ilaçe dhe vërtet ia nxori. Për ta vërtetuar zotësinë e Mistos si mjek të talentuar, më thanë të takoja qytetarin, Dhimitër Ilo (Miçon). E takova.

-Kam dëgjuar që në vitin 1968 ke vojtur nga veshkat. Kush të mjekoi? Pa u menduar, duke u ngashëruar, me mirënjohje dhe respekt, u përgjigj:

- Dr. duar artë e mendje ndritur pogradecar, Misto Markua. Ju luta të më kallzonte ngjarjen.

-Si i thashë ku më digjte dhe më dhimbe në trup, mori një libër, e hapi, u konsultua me të dhe më thotë buzagaz:

- Ke një infeksion të lehtë në veshkat. Me humor më premtoi se

së shpejti do ta pushkatojmë. Me gjithë që kisha dhimbje e falenderova. Më shtroi në spital, mjekoi, për një muaj më dërgoi në spitalin Nr.1, te Dr. Josif Adhami. Si m' i bëri të gjitha analizat më pyeti?

-Cili mjek të ka mjekuar në Pogradec?

-Dr. Misto Markoja. Më porositi.

-Shko falenderoje. I thuaj të të japë këto medikamente dhe një muaj tjetër. Ne mua s' ke më punë të vish. E në të vërtetë që nga viti 1968 e deri më sot, unë s' kam ndjerë dhimbje nga veshkat. Mistua i pushkatoi mikrobet. Infermieri Vasfi Cake shtoi edhe këtë kontribut human të tijin:

-Mistoja jo vetëm në qytet, por edhe në fshat ka dhënë një ndihmë të madhe. Disa herë në vit organizonte ekipe shëndetësore dhe kontrollonte të sëmuret. Aty nga viti 1970 në qytet erdhën disa mjekë të tjerë pogradecarë si Naim Zgjani, Nikolla Niça, Kristaq Nuçi, Qirici, Spiro Nastua, Sotiraq Piliçi, Petraç

Cici, Fuat Demiraj, etj. Një herë në muaj vini specialistë të tjerë nga Korça. Njihja Marika Bellovodën, Zhani Sofronin, Gaqo Kanen. Kishin respekt për Dr. Miston. "Diagnozat e tij ishin të sakta. Mjekimet të pagabuara. Dr. Mistua nga viti 1954 e deri sa doli në pension 1990 u shërbeu të sëmureve për t'ua lehtësuar dhimbjet e zgjatur jetën. Por jo vetëm në shëndetësi, por edhe në kulturën e jetesës, me edukatën dhe sjelljen e tij emancipoi edukatën qytetare dhe fshatare. Ndaj atij të gjithë jemi mirënjohës. Para se të largohesh për në Amerikë bashkë me dy intelektualët Anastas Kostandinin dhe Gjergji Lakon e vizituam. I uruam udhëtim të mbarë dhe të na kthehesh këtu në vendlindje i shëndetshëm. Në emër të miqve dhe shokëve të tu, e gjithë qytetarëve dhe fshatarëve që ju ke shërbyer të urojmë shëndet. Me të drejtë Këshilli i Bashkisë së qytetit, për kontributin që ke dhënë në shërbim të shëndetit të popullit dhe emancipimin e tij, të nderoi me titullin e nderit "Krenari e Qytetit". Të presim të na vish shëndoshë nga Amerika.

**Tom Mato**

# Shpirti Mokrar

I shtyrë nga dëshira e madhe, e ndjej detyrë të shkruaj për cilësitë e shpirtit Mokrar. Më ra fati të punoja specialist në Gjendjen Civile prej vitit 1947 deri në vitin 1983, plot 46 vjet, kur dola në pension, detyrë të cilën e kreu me ndershmëri.

Natyrë e punës kishte të bënte me popullin, t' i shërbeja, duke i vlerësuar sikur t' i kisha vëllezër e motra.

Duke shkuar në çdo fshat u shpegonja Kodin Familjar, që aq shumë ishte i nevojshëm. Pushteti Lokal më dërgonte në fshatra edhe në fushata ekonomike, krahas saj bënja edhe punë bindëse nëpërmjet shtypit. Nuk kam lënë familje e fise pa i njohur ashtu si të gjithë kuadrot e tjerë. Populli i priste dhe i vlerësonte ata.

Po çfarë karakteri ka mokrari? Një popull bujar dhe mikpritës, një

popull me dashuri dhe dhëmbshuri, bujar, humanitar. Në ato vite Mokra ishte analfabete, por zemërgjerë nga të gjitha.

Të rrinje me mokrarët, të punoje dhe të bisedoje me ta, unë e quaj shkollë të madhe. Të gjitha familjet të prisnin me kënaqsi, të cilën do ta vlerësoja kështu: hanja bukë me mjaltë, se mjaltë është fjala e tyre. Me ta bisedoje çdo problem, të cilët i dëgjoja me vëmendje dhe i vlerësoja seriozisht.

Një nga ato ngjarje: kish ndodhur një grindje në Çervenakë në një familje nga një zjarr. Të afërmit ishin interesuar të zgjidhej. Fajtori ishte gjendur. Por ishte e pamundur. Këtë mund ta zgjidhte vetëm Petroja, që ishte në Podkozhan, që kishte ardhur nga Çervenaka. Ishte një plak me shumë pjekuri, të cilit i kërkoi

ndihmë Çausi i Çervenakës. Petroja nuk nguroi, por pasi e priti si mik e si vëlla, e dëgjoji dhe të dy u nisën drejt fshatit.

Fjala e Petros, mendimet e tija bënë që grindja të sqarohet e të mbyllet me mirëkuptim e me dorë në qafë. Gjithë farefisi pleqtë e nderuar e të mençur fshati i nderoi sipas zakonisht.

Ndër mokrarët është i vlerësuar dhurimi i fëmijve njerëzve të afër dhe ky nuk është një rast: të tillë ka në Kalivaç, Podkozhan, Pleshisht, Dunicë, Jollë e të tjerë. Kjo ka sjellë edhe një dashuri dhe mirëkuptim edhe më të madh midis tyre, por edhe më gjerë.

Një rast: Gjok Tola me Ligorien i falin djalin Risto Pjetrit nga Pleshishti, duke e uruar: ta mbushtë derën plot! Dhe për çudi ai me familjen e tij lindën 10 fëmijë. Vetëm nga ky djalë u bë 10 herë krushk, 20 herë nga fëmijët e tjerë, gjithësej 36 herë.

Mokrarët me zemër të madhe e

të gjerë dinë të falin edhe gjakun, me arësyen e fortë e të kthjelltë dhe raste të tilla ka në Mokër.

Mokrari nuk e ka patur në traditë të përvetësoi pasurinë e të tjerëve, nuk ka qenë vjedhja cilësi e tij.

Shpirti mokrar është i pasur edhe me shprehje urimi, kur përshëndetin: Zoti të nderoftë e të gëzoftë! Ta shtoftë e të tjera.

Sofra mokrare është një pasuri tjetër me vlera, punëtorë, të këngës e të muhabetit. Nuk është rastësi që shumë çupa mokrare janë nuse në qytet. Mokra i ka dhënë kombit tre dëshmorë të gjuhës shqipe: Gjok Shqiptarin, Aleks Andrea (Hoshtëça), Apostol Kollçakun.

Mirëkuptimi, toleranca, bashkëjetesa fetare është një tjetër vlerë e Mokrës dhe e mokrarëve kudoqë ndodhen.

Këtë e tregojnë miqësitë, krushqitë, vizitat dhe gjithëçka flet në të mirë të këtij komuniteti e pse jo edhe të këtij Kombi.

**Vangjel Burnazi**



**B**abai ynë Fero lindi në Slabinjë të Pogradecit nga një familje e madhe fisnikësh e tregëtarësh. Fëmijëria e tij ishte e qetë, e bukur, por pak e shkurtër, pasi që në moshë të vogël rreth 10-12 vjeç i duhej të merte përsipër vazhdimsinë e tregëtisë, e cila kishte nisur që nga gjyshi dhe të afërmit e tjerë të familjes Fero. Dyqanet ishin njëri pas tjetrit në Slabinjë, në Ramje të Zemçes, në Omçan dhe në Selcën e Sipërme. Kjo familje kishte futur në këto dyqane të afërmit e saj. Për të ecur më tej familja vendosi që tregëtia të zhvendosej dhe në qytetin e Pogradecit dhe ashtu u bë. Në vitin 1938 xhaxhai i babait Kurti hapi dyqan në Pogradec.

Nga të gjithë nipërinjtë ai zgjodhi Feron. Një djalë i shkurtër, i bukur, i çiltër, i zgjuar, i kujdesshëm dhe pa fjalë. Sipas rrëfimeve të babait tim në dyqan rrinte Feroja, kurse furnizimin e dyqanit e bënte xhaxhai. Dyqani po merrte drejtim të mirë dhe në Pogradec sepse malli ishte i veçantë dhe merrej në Itali. E kështu vazhdoi tregëtia, por vitet kaluan dhe filloi lufta e cila solli pengesat e saj. Por puna vazhdoi mirë. Lufta duhej ndihmuar dhe sipas rrëfimeve të babait tim vinte Nuçi Tira dhe na kërkonte ushqime dhe veshmbathje të cilat nuk i kursyem asnjëherë. U çlirua vendi dhe rreth viteve 1946 u mbyll dyqani nga shteti duke mos lejuar tregëtinë private.

Një perde e zezë mbuloi dritaren e familjes Fero, nga ajo dritare, ku familja Fero shihte shumë larg, kështu ishte shkruajtur nga Zoti. Babai u kthye përsëri në fshatin e tij në Slabinjë. I vrarë shpirtërisht, por edhe më i burrëruar, më i zgjuar dhe më i shkathët, një tregëtar i mirëfillte, duke vazhduar edhe shkollën në Pogradec, ku u bë një ekonomist i fortë. Kur Partia mori pushtet u ngrit kooperativa por duhej edhe një ekonomist i mirë, ku kryetari i saj vendosi që të merte Feron. Rreth vitit 1950 babai martohet dhe merr në një fis të ndjerë në Slatinë çupën e



# Përjetësi në tregëti

Selim Lekës.

Nëna jonë quhej Hanife. Filloi jeta si kudo edhe në familjen Fero. Një jetë do të vazhdonte afër 60-vjet martesë. Por gëzimet erdhën përsëri tek kjo familje, dhuratat nga Zoti s'mungonin ishin 9 fëmijë. Katër fëmijët e parë lindën në Slabinjë. Në fund të vitit 1960 hapet stabilimenti në Bishnicë. Drejtori i saj ishte Halit Çela, ku i kërkoi Hamit Balliut që ta transferonte Feron në Bishnicë. Hamiti pranoi dhe babai ia çmonte gjithmonë i ishte mirënjohës, fjalët e tij ishin: Më ke shpëtuar fëmijët nga buka e misrit.

Në vitin 1961 në Bishnicë filloi një jetë e re familjare dhe shoqërore në një vend të bukur nga natyra, ku buronte një ujë i kristaltë një gjelbërim i mahnitshëm. Një popullim i pakët, por vite më vonë do të bëhej një qytezë e bukur plot gjelbërim. Qyteza gumëzhinte nga zërat e

punëtorëve, motorsharat. Babai ju bënte llogarinë dhe ju ndante rrogat e tyre. Filloi një epokë e re ku babi kokëulur pa llafe, gojëmbël me punëtorët, i ndërgegjshëm për atë që shkoi dhe optimist për atë që po vjen, të afërmen e tij dhe të familjes. Dhe kështu paratë nëpër duar, fëmijët e parë rriteshin, të tjerët vinin nga pas. Pothuajse afër një vit njëri pas tjetrit. Të gjithë u rritën në sajë të nënës sonë Hanifesë, si mos më mirë.

Asgjë nuk mungonte në familjen tonë në sajë të të dy prindërve tanë, që punonin pa u lodhur për të rritur. Të nëntë fëmijët e tyre, kur të vegjëlit vinin në jetë të rriturit ndihmonin nënën për fëmijët e tjerë. Erdhi koha për të bërë martesat me rradhë të gjithë fëmijëve. Prindërit nuk donin që fëmijët e tyre të jetonin më në fshat. Dhe kështu u bë. Asnjë nga fëmijët e tyre nuk u martua dhe jetoj aty kjo

ishte jeta e bukur, e lumtur për të dy. Me një mbyllje të këndshme për drejtimin e fëmijëve të tyre në jetë.

Po vjen koha dhe vitet ikin pa kuptuar dhe të dy prindërit tanë nëna madhështore, një grua e gjatë, e bukur me një trup të drejtë si sorkadhe dhe babai jo shumë i plakur mes halleve të jetës. Po lindnin nipëra, shtoheshin gëzimet. Jeta po merrte drejt nga pleqëria. Nëna Hanife doli në pension rreth viteve 1979 kurse babai rreth vitit 1986. Fëmijët babai i rregulloi me zotësinë e vet nëpër shkolla, punë të ndryshme me ndihmën e miqve të tij të vjetër në Pogradec se përndryshe nuk i jepte njeri bursa për shkolla, punë duke qenë se fëmijët mësonin dhe punonin. Në fundin e vitit 1989 filloi lëvizja për Demokraci, babai po ndiente diçka për ndryshimin e madh që do të ndodhte rreth viteve 1990. I qetë, një natyrë e mbyllur, pa fjalë do të mendonte në veten e tij, ku për herë të dytë në jetën e tij me emrin e zotit në gojë, me bismilaj do të fillonte tregëtinë nga e para.

Unë, djali i tij i vogël Agimi bashkë me vëllain tim Nexhmiun punonim në minierën e qymyr gurit në Vërdovë. E di vetë ai me sa mundim na futi në minierë. E vetmja punë ku mund të uleshim me banim në qytet. Babai e haroi atë. Më thirri mua Agimin ku fjalët e tij ishin: do vish me mua, do fillojmë tregëtinë. Dhe kështu u bë. Një çantë e madhe e mbushur me mastika, biskota, çokollata, paketa, shkrepsë etj. Shkollë më shkollë, Bishnicë, Velçan, Slabinjë, Proptisht, Losnik. Kjo ishte rruga jonë e përditëshme. Në fund të vitit 1990 nuk po i durohej më. Do hapnim një klub.

E vështirë, sepse përpara ishte akoma shteti por duke u rrënuar. Me dy klube të tjera përballë e ndërtoam klubin tonë siç na mësoi babai bashkë me vëllain Gëzimin dhe nusen e Shemes, Bardhën. Bashkëfshataret tanë disa gëzoheshin, disa habiteshin. Nga goja e tyre rridhnin gjithmone këto fjalë të mira çiltërsie: si ka mundësi përsëri Feroja. Por ne nuk na pengonin fjalët e tyre puna ishte gjithçka për ne. Klubi eci shumë mirë në sajë të fjalëve të mira.

**Agim Fero**

# Horoskopi javor i "Nositit"



## Dashi (21.3-20.4)

Marrëdhëniet tuaja në familje prirën të bëhen më të qëndrueshme. Fundjava pritet të jetë e këndshme.

## Demi (21.4-20.5)



Suksesi këtë javë do të jetë juaji, prandaj mbliidhni energjitë dhe kini besim tek vetja juaj.

## Binjakët (21.5-21.6)



Nuk duhet t'u besoni këtë javë shumë premtimeve të tepërta të personave që ju rrethojnë.



## Gaforrja (22.6-22.7)

Duhet të jeni më të kursyer përsa u përket shpenzimeve të kohës, energjive dhe parave.

## Luani (23.7-23.8)



Personi me të cilin do të dëshironit të kishit marrëdhënie të ngushta s'e meriton vëmendjen tuaj.

## Virgjëresha (24.8-23.9)



Kujdesi juaj për t'iu përgjigjur njerëzve në nevojë do të jetë në nivelin maksimal të mundshëm.



## Peshorja (24.9-22.10)

Do të merrni pjesë në një festë në fundjavë. Investimi i filluar do të japë frytet e dëshiruara.

## Akrepi (23.10-22.11)



Duhet të luftoni për të kufizuar humorin e keq. Surpriza mjaft të këndshme në fundjavë.

## Shigjetari (23.11-22.12)



Duhet të mënjanoni një sfidë që përpiqet t'ju bëjë një kolegu juaj. Ngatërresat ju bëjnë pesimist.

## Bricjapi (23.12-20.1)



Këtë javë do të jetë momenti i duhur për të bërë projekte për të ardhmen bashkë me familjarët.

## Ujori (21.1-19.2)



Do t'ju ecë në çdo vendim që do të merrni. Mund të programoni një mbremje me miq dhe shokë.

## Peshqit (20.2-20.03)



Javë jo e mirë, por në vend që të ankoheni përpiquni të reagoni për të mënjanuar shkaqet.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
13			14		15			16			
		17			18						
19	20							21	22		
23				24				25			
26				27				28			
	29		30								
	31			32	33	34					
			35			36			37	38	
39				40				41			
42			43				44	45			
46		47		48			49				
50			51			52		53			

**Horizontalisht:** 1.Roman i Bokaçios 9.Emri i shkrimtarit Tuein 13.Lëvizja e ajrit 14.Targa e Ersekës 15.Thirje për ndihmë nga anijet në rrezik 16.Vullkan në Itali 17.Vladimir..., poet rus 19.Maku i dramës "Toka jonë" të K.Jakovës 21.Fitnete..., kantautore strugane 23.Akoma në dialekt 24.Shtet euroaziatik 26.I përdorin ata që rrëshqasin në akull 28.Opera e P.Jakovës 29.Këngëtarja Koka, inicialet 30.Një... lind në mendje 31. ...bufe 32.Ishte... i Popullit Pandi Raidhi 35.Dy mijë për romakët 36.Këngëtarja Oksa, inicialet 37.Shtatë romake (në invers) 39.Romani "...e armëve" i P.Markos 40.Shkrimtari Zola 42.Lumë në Itali 43.Aktori italian Xhirone 44.Kryeqyteti i Taivanit 46.Një... që formohet nga rrëshqitjet e dëborës 48.Metal fisnik 49.Emri i Bismarkut 50.Përemër vektor 51.Rrjedhin nga sytë 52. ...Montan 53.Vargmalet në Amerikën e Jugut

**Vertikalisht:** 1.Formohet në grykën e lumit 2.Targa e Ersekës 3.Gadishull rus në Lindjen e Largët 4.Rexhep... ka qenë president 5.Mund të jetë fllad i lehtë 6.Patrioti Kuka 7.Qytet serb 8.Instituti i studimeve statistikore 9.U zverdh u bë... 10.Mati pa notën muzikore 11.Aktori Ndrenika, inicialet 12.Romani "vëllezërit..." i Dostojevskit 18.Xhimi..., ka qenë president i SHBA 20.Kryeqyteti i Mongolisë 22.Odise ose... në Itali 25.Xhuljo... ka qenë kryeministër i Italisë 27.Shkrimtari polak Mickeviç 33.Ekipi berat as i futbollit 34.Mund të jetë morale 35.Futbollisti holandez Van Basten 38.Këngëtarja italiane Grande 39.Një... publicitar 40.Këngëtarja Qazimi 41.Një qytet francez 45.Ai dhe ajo 47.Targa e Elbasanit

## Përgjigjet e fjalëkryqit të numrit të kaluar (Nr. 469)

**Horizontalisht:** 1.Dhori 4.Darvini 10.Rio 11.Se 12.SP 13.Oliveri 15.Spanja 16.Nen 17.Ka 18.Mi 20.Esenin 24.Kin 25.Tra 26.Angola 28.LU 29.Briti 32.JK 33.Sto 34.Sara 36.Imre 37.LU 38.Shqipe 39.As 40.Ke 41.Malta 44.ZZ 45.Kodra 47.Mig 49.Uçi 50.LT 52.Oka 54.ALB 55.Kina 56.Mima

**Vertikalisht:** 1.Dhori 2.Oliver 3.Irene 4.Drini 5.Ai 6.Rosa 7.Isak 8.Nëna 9.MP 12.Sami 14.Rendi 19.Indonezia 21.Sabri 22.Naim 23.Agjenti 24.Kasus 25.Tushe 27.Ok 30.Rapidi 31.Ti 35.Ag 37.La 38.Skela 41.Mali 42.LM 43.Agim 45.Kub 46.Oç 48.Tom 51.TN 53.Ka



### Ligjërata

Polici e ndali një pijanec në orët e vona të natës dhe e pyeti: -Ku je nisur në këtë kohë? -Në ligjërata. -Kush mban ligjërata në këtë kohë? -Gruaja ime!

### Konkursi

Në një konkurs për autobiografinë më të shkurtër, çmimin e parë e fitoi gruaja që shkroi: "Kur kam qenë e re, kam pasur fytyrë të lëmuar dhe kam veshur fustan me rrudha. Tash është e kundërta..."

### Çerekfinalja

Në dasmë një njeri iu afrua një djaloshi dhe e pyeti: -A mos jeni ju, ndoshta, dhëndërrin? -Jo, se për fat të keq jam eliminuar që në çerekfinale!-iu përgjegj djaloshi me keqardhje.

### Marrëveshja

Martohet gjirokastriti i ri. Erdhi momenti që t'ia vërë nuses unazën në gisht. -Besoj se ky është vetëm një formalitet - i flet ai në vesh gruas, - dhe unazën do të ma kthesh sërish.



**Hotel Bar Restorant**



**Pogradec, ALBANIA**

**Tel: 083 224600**

**Fax: 083 224611**

**Mob: 0692080394**

**www.hotel1maji.com**



**Botimet më të mira 2009**

1. *Libri më i mirë poetik:*

“Mos e ndiqni hijen”, nga **Edmond Shallvari**

2. *Libri më i mirë në prozë:*

“Borëbardha flokëthinjur”, nga **Vangjush Ziko**

3. *Libri më i mirë me studime:*

“Ringjallet Rilindja e Lasgushit. Po unë?” nga **Petro Prifti**.

*Në vlerësimin e botimeve më të mira të Sh.B. "D.I.J.A. Poradeci" juria ka mbajtur parasysh të gjithë komponentët e një libri: nivelin artistik të tekstit, realizimin grafik dhe kopertinën, cilësinë e shtypit.*



**BANKA  
POPULLORE**

**SOCIETE GENERALE GROUP**

**Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO**

**Në kompjuter: Edlir PODA**

**Lexoni gazetën në: [www.poradeci.com](http://www.poradeci.com)**

**Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë**

**Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci", -Pogradec**

**Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec**

**Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753**

**e-mail: [afrovitig@yahoo.com](mailto:afrovitig@yahoo.com);**

**[redaksianositi@yahoo.com](mailto:redaksianositi@yahoo.com)**